



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 57/20 Prot.

Tiranë më 21.10.2024

V E N D I M

Nr. 50 Datë 21.10.2024

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Suela Bulku Kryesuese

Arben Sefaj Relator

Denisa Sina Anëtare

Në datën 09.10.2024, në Godinën e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, kati 1, asistuar nga anëtarja e sekretariatit teknik Znj. Ersila Kalaja, zhvilloi seancën dëgjimore publike për çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT:

Z. Lorenc Gëzim Shehu, me funksion
Zëvendës drejtor për Rendin dhe Sigurinë në
Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi dëgjoji gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes z. Arben Sefaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Z. Lorenc Gëzim Shehu, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikën 1, të nenit 4, të Ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar.

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Z. Lorenc Shehu është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023 si, *Drejtor i Qendrës në Qendrën e Mbyllur të Huajve, në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*
2. Aktualisht me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. ***, datë 20.06.2024, protokolluar me tonën me nr. *** prot., datë 28.06.2024, Drejtues Lorenc Shehu për nevoja pune transferohet dhe emërohet në detyrën e *Zëvendës drejtor për Rendin dhe Sigurinë në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.*
3. Funksioni që mban aktualisht, subjekti i vlerësimit i nënshtrohet procedurave të Vlerësimit Kalimtar/Periodik në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, neni 6, “Fushat e ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të vlerësimit kalimtar” pika 1/a.
4. Subjekti i vlerësimit, Z. Lorenc Shehu iu nënshtroi procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 04.07.2023 nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. 1 datë 13.07.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Suela Bulku Kryesuese, Z. Arben Sefaj Relator, dhe Znj. Denisa Sina Anëtare.
6. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin Nr.1 datë 13.07.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Lorenc Shehu.

7. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 14.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. *** datë 17.07.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë.
 - Kontrollin e figurës.
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
 - c. Ligji nr. 40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”.
 - d. Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.
 - e. Ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
 - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
 - g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.
 - h. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në DPPSH që janë:
 - *Deklarata e Pasurisë,*
 - *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
 - *Formulari i Aftësive Profesionale,*
 - *Dokumentacioni bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet,*
 - i. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
 - j. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.

- k. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
13. Trupa e Vlerësimit, me datë 27.09.2024, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Lorenc Shehu, me Vendimin Nr.2 datë 27.09.2024, vendosi;
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Lorenc Shehu.
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
- *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht,*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional,*
- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa Vlerësuese, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Lorenc Shehu, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtrroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 09.10.2024, subjekti i vlerësimit Lorenc Shehu kërkoi konfirmimin në detyrë. Trupa e Vlerësimit shpalli vendimin më datën 21.10.2024, për subjektin e vlerësimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

16. Z. Lorenc Shehu, ka qenë korrekt dhe bashkëpunues gjatë procesit të vlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

17. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, “Vlerësimi i pasurisë”, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
18. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Lorenc Shehu ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 08.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr.***, index 2023.
19. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32, dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
20. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
21. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
22. Bazuar në nenin 32, pika 1.1, të ligjit nr. 12/2018 ”Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim”. Neni 1 citon; “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë”.

Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si edhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike;

23. **Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaramëve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

24. Lorenc Shehu është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI në vitin 2015, me numër indeksi *** dhe sipas deklaramit online me numër indeksi ***. Në zbatim të ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaramat e interesave private, dhe përveç këtyre bazuar në ligjin nr. 12/2018 "*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat*" i ndryshuar, ka plotësuar edhe deklaramtën e pasurisë për vlerësimin kalimtar me datë 08.03.2023, ka dorëzuar ndër vite deklaramat e interesave private, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës 2015
- Periodike/Vjetore 2015
- Periodike/Vjetore 2016
- Para fillimit të detyrës 2019
- Periodike/Vjetore 2019
- Periodike/Vjetore 2020
- Periodike/Vjetore 2021
- Periodike/Vjetore 2022
- Periodike/Vjetore 2023

25. Për kryerjen e kontrollit të plotë të deklaramtës së pasurisë së subjektit Lorenc Shehu, ILDKPKI ka krahasuar Deklaramtën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar, etj., të dorëzuar nga vetë subjekti, deklaramat e interesave private ndër vite, me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me nr. *** prot., dt. 24.07.2023.

26. Kontrolli i plotë kryhet për periudhën deri në datën e dorëzimit të Deklaramtës së Pasurisë për vlerësimin kalimtar, që përfshin këtë deklaramtë dhe deklaramat e interesave private ndër vite.

27. Bazuar në nenin 32, pika 1.1, të ligjit nr. 12/2018 "*Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat*" i ndryshuar, "Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim". Neni I citon; "Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe

Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

28. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, me shkresën nr. *** datë 29.04.2024 protokolluar me tonën me shkresën nr.*** datë 30.04.2024, “Dërgohet akti i përfundimit të plotë të kontrollit të Deklaratës së pasurisë për Vlerësimin Kalimtar”, në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, bazuar në dokumentacionin e administruar, konstatohet se, për subjektin e vlerësimit z. Lorenc Shehu:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare,
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- c) nuk është kryer deklarim i rremë,
- d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

29. Në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, është deklaruar:

DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT- LORENC SHEHU

DEKLARIMI I PASURIVE:

30. 1. **Apartament banimi me sipërfaqe 62.5 m², me adresë: Rruga “****”, Pallati nr. ***, Hyrja nr. ***, Apartamenti nr. ***, Kodi Postar 1016, Njësia nr.****, Tiranë**, e blerë dhe hipotekuar në vitin 2013. Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.06.2013, lënë si kolateral në BKT. Burimi i krijimit: Të ardhura nga kursimet ndër vite. Të ardhura nga ekzekutimi i Vendimit Gjyqësor të Gjykatës së Lartë nr. ***, shuma 7.757.530 lekë. Vlera: 31.500 euro. Zotëron 100%. Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 26.09.2013, për pasurinë nr.*** vol. ***, faqe ***, zk. 8360, e llojit apartament, me sipërfaqe 62.5 m², me adresë: Rruga “****”, Hyrja ***, Apartamenti ***, Tiranë, në pronësi të Lorenc Gëzim Shehu.
- Kartela e pasurisë nr. ***, vol. 17, faqe ***, zk. 8360, e llojit apartament, me sipërfaqe 62.5 m², me adresë, Tiranë, Rruga “****”, Sh.***, K. ***, Ap. ***, regjistruar në pronësi të Lorenc Gëzim Shehu, në datën 26.09.2013.
- Kontratë Shitje nr. *** rep., nr. *** kol, datë 01.06.2013, me blerës Lorenc Shehu dhe shitës shoqëria “****” ShPK, për blerjen e pasurisë nr. *** vol. ***, faqe ***, zk. 8360, e llojit apartament, me sipërfaqe 62.5 m², me adresë: Rruga “****” Tiranë, me vlerë 31.500 euro, të likuiduar jashtë zyrës noteriale. B/lidhur: Praktika.

- Vërtetim datë 13.04.2018, lëshuar nga Shoqëria *** shpk, ku vërtetohet se, në datë 23.12.2011 është depozituar kërkesa e palës kreditore Lorenc Shehu dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë 04.03.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 15.11.2011, për shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror në masën 7.757.530 lekë nga debitori Shoqëria e Sigurimeve “****”sha. Vendimi është ekzekutuar plotësisht pasi palës kreditore i ka kaluar shuma 7.305.105 lekë në llogarinë e tij, në datën 13.08.2012 dhe në bazë të proces-verbalit, kreditori ka marrë edhe shumën prej 400.000 lekë. B/lidhur: Statement transferimi fondesh nga Emporiki Bank, datë 13.08.2012, ku rezulton transferimi nga llogaria e *** ShPK, në llogari të Lorenc Shehu, i shumës 7.305.105 lekë, me përshkrimin kalim për ekzekutim vendimi.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE E A.M.P.

- ✚ Banka Amerikane e Investimeve me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se, në emër të Lorenc Shehu, rezulton llogari kursimi në Lek, e hapur në datën 13.08.2012, me balancë të bllokuar 5.162 lekë, prej datës 20.12.2016. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi me transfertë i shumës 7.305.105 lekë, në datë 13.08.2012, me përshkrimin, “kalim nga *** ShPK, për ekzekutim vendimi, debitimi me transfertë i shumës 6.400.000 lekë, në datën 13.08.2012, me përshkrimin nga Lorenc Shehu tek A. Sh., parapagim për blerje apartamenti si dhe tërheqja cash e shumës totale 900.000 lekë, në datën 15.08.2012.
- ✚ ASHK (online) konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk. 8360, e ndodhur në Tiranë, në pronësi të Lorenc Gëzim Shehu, me status “aktive”.
- Në proces-verbalin e datës 25.03.2024, subjekti ka sqaruar se prej mbarimit të studimeve në vitin 1994 deri në Vitin 1997 ka banuar pranë familjarëve të tij në Tiranë, prej vitit 1997 deri në vitin 2004 ka banuar me qira në godinat e Qytetit Studenti, në Tiranë dhe konkretisht, në godinën nr. *** (e emërtuar si godina e familjarëve) dhe prej vitit 2004 deri në vitin 2007 ka banuar në apartament me qira në rrugën “****”, Tiranë, për të cilat, për shkak të kohës së kaluar, nuk disponon dokumentacion justifikues, duke sqaruar se: shpenzimet për periudhën 1997 - 2004 kanë qenë me vlerë rreth 2.000 lekë/muaj për qiranë dhe rreth 2.000 lekë/muaj për furnizimin me energji elektrike dhe uji, me burim financiar nga të ardhurat nga pagat, ndërsa për periudhën 2005 - 2007, shpenzimet për banim me qira në lagjen “****”, Tiranë, kanë qenë rreth 10.000 lekë/muaj, me burim financiar nga të ardhurat nga pagat. Gjithashtu, sqaroi se, në vitin 2007 ka marrë në dorëzim apartamentin e deklaruar me sip. 62.5 m², duke paguar shumën totale 31.500 euro, të likuiduar me para në dorë (cash), pjesë - pjesë, deri në datën 01.06.2013, referuar kontratës së shitjes (sipas dokumentacionit të dorëzuar) dhe për të vërtetuar këtë fakt, sqaroi se paraqet formularin e regjistrimit të numrit të telefonit në emrin e tij në datën 19.12.2007, ku figuron adresa e apartamentit të deklaruar, si dhe fletë-thirrje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e kryer në adresën e këtij apartamenti në datën 09.02.2009. Subjekti sqaroi se, mobilimi i këtij apartamenti është kryer ndër vite, me burim financiar kursimet familjare dhe për këtë arsye nuk disponon dokumentacion shtesë lidhur me vlerën dhe periudhën e mobilimit. Gjithashtu, sqaroi se, apartamenti është përdorur për banim deri në vitin 2018 dhe konfirmoi se është përdorur për të krijuar të ardhura nga dhënia me qira prej muajit dhjetor 2019 dhe në vijim, sipas deklarimit dhe dokumentacionit të paraqitur. Lidhur me burimin financiar për blerjen e këtij apartamenti, subjekti konfirmoi se kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare ndër vite dhe pjesërisht shuma e përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor.

- B/lidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024, u administrua:
 Deklaratë nga shtetasi P.K., si përfaqësues i shoqërisë “****” ShPK, datë 19.03.2024, i cili deklaroi se midis shoqërisë “****” ShPK dhe shtetasit Lorenc Shehu është negociuar që në përfundim të objektit të ndërtimit (të nisur në v. 2003) ky shtetas të merrte në posedim, me synim blerjen pas hipotekimit, një apartament me sip. 60-65 m², të cilin do ta likuidonte pjesë-pjesë, me çmim 500 euro/m² dhe në vitin 2007, kur mbaroi ndërtimi i këtij objekti, apartamenti iu dorëzua shtetasit Lorenc Shehu dhe në datën 01.06.2013, u nënshkrua kontrata e shitjes përfundimtare e apartamentit me sip. 62.5 m², me adresë: Rr. “****”, P. ***, Ap. ***, K. ***, kodi postar 1016, Njësia nr. 9, Tiranë, duke theksuar se shuma totale e shitjes prej 31.500 euro është likuiduar cash (pjesë - pjesë) prej marrjes në posedim të apartamentit deri në ditën e nënshkrimit të kontratës së shitjes.
 B/lidhur praktikës: Vërtetim nga dokument hipotekor datë 21.05.2013, ku vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 27.12.2006, figuron i regjistruar në pronësi të “****” ShPK, pasuria nr. ***, zk. 8360, e llojit apartament. me sip. 62.5 m², i ndodhur në Rrugën e ***, Tiranë.
 - Formular regjistrimi nga Vodafone Albania sha, datë 19.12.2007, për klientin Lorenc Shehu, me adresë Rr. “****”, Pallati “Ish Kinema ***, Tiranë.
 - Fletë-thirrje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 09.02.2009, drejtuar shtetasit Lorenc Shehu, me adresë: Pallati i ri pranë Kinema ***, Tiranë.
 - Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 15.11.2011, me paditës Lorenc Shehu dhe i paditur “****” sha, ku është vendosur: Lënia në fuqi e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. ***, datë 04.03.2011.
 - Vendim i Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 12.07.2012, me paditës Lorenc Shehu dhe i paditur “****” sha, ku është vendosur: Mospranimi i rekursit të paraqitur nga pala e paditur, kundër Vendimi i të Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. ***, datë 15.11.2011.
 - Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:
 Apartamentin me sip. 62.5 m², subjekti e ka marrë në posedim për banim në vitin 2007 dhe shumën totale të blerjes prej 31.500 euro, e ka shlyer deri në blerjen përfundimtare sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.06.2013, me burim financiar kursimet nga të ardhurat familjare dhe të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në dalë 13.08.2012. Këtë pasuri e ka përdorur për të gjeneruar të ardhura sipas kontratave të qirasë, prej vitit 2019 dhe në vijim.
 - ✓ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me apartamentin me sipërfaqe 62.5 m², me adresë: Rruga “****”, si dhe burimin financiar të krijimit.
 - ✓ Subjekti ka deklaruar shpenzime për banim me qira për periudhën 1997 - 2007, në shumën totale rreth 750.000 lekë, duke mos disponuar dokumentacion justifikues.
31. 2. **Apartament banimi me sipërfaqe 102.82 m², me adresë: Rruga “****”, Ndërtesa nr. ***, Hyrja nr. ***, Apartamenti nr. ***, Tiranë, e blerë në v. 2008, me vlerë sipas kontratës 53.768 euro.** Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2008. Banesë e legalizuar dhe hipotekuar në datën 03.08.2021, ku sipërfaqja sipas certifikatës së pronësisë përfundimisht ka dalë 102.82 m², Zk 8330, nr. pasurie ***. Burimi i krijimit: Kursime familjare ndër vite. Huamarrje në vlerën monetare 20.000 euro sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., Prill 2018 nga shtetasi L.B.,

32. Sqaroj se, në momentin e blerjes së shtëpisë është paguar shuma 45.000 euro dhe shumën e mbetur prej 8.768 euro e kam konvertuar (nga kursimet familjare ndër vite) duke kryer punimet e ngelura në shtëpi përgjatë viteve 2009, 2010, pasi, firma ndërtuese nuk i përfundoi punimet sipas kontratës. B/lidhur, dokumentacioni (situacioni) ku janë njohur këto punime nga firma ndërtuese, pasi janë kryer të gjitha veprimet ligjore midis meje dhe firmës “****” ShPK për njohjen e shumës 8.768 euro.

33. Nëpërmjet Akt Marrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.10.2022 (për shkëmbim në të ardhmen të sendit të ardhshëm) apartamenti me nr. pasurie ***, zk. 8330, me sipërfaqe 102.82 m², i kompletuar me të gjitha pajisjet, do të shkëmbehet me apartamentin nr.*** (2+1), Hyrja ***, i cili ndodhet në katin ***, në kuotën *** të pallatit me sipërfaqe 118.3 m², i pa mobiluar (i sapo ndërtuar). Shkëmbimi do të realizohet në kohën e përfundimit të apartamentit. Kjo Akt-marrëveshje ka si bazë vetëm shkëmbimin e pronës, pa detyrime financiare të ndërsjella. Pasuritë e paluajtshme do të shkëmbehen brenda 30 ditëve, pas marrjes së lejes së shfrytëzimit nga shoqëria “****” ShPK, të Apartamentit nr. ***, H.***. Shuma e paguar 45.000 euro. Shuma 8.768 euro është njohur e shlyer nga kryerja e punimeve të ngelura pasi u la banesa e papërfunduar nga ndërtuesi. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2008, me porositës Lorenc Shehu dhe sipërmarrës “****” ShPK, përfaqësuar nga N.B, për blerjen e apartamentit nr. ***, në seksionin*, kati *** të, me sipërfaqe totale 103.41 m², nga të cilat, 6.59 m² ambiente të përbashkëta. Çmimi i blerjes 53.768 euro, nga të cilat; shuma 45.000 euro si këst i parë është paguar me nënshkrimin e kontratës jashtë zyrës noteriale dhe shuma 8.768 euro si këst i dytë, do të likuidohet në momentin e dorëzimit të apartamentit. B/lidhur praktikës: Fleta e fundit e deklaratës noteriale me deklarues N.B, si administrator i shoqërisë “****” ShPK, ku rezulton e cituar nga z. Lorenc Shehu, shumën prej 2.500 euro si këst i tretë në zbatim të kontratës së porosisë.

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.09.2015, me deklarues I.D. dhe K.A. (si përfaqësues të posaçëm të N.B.) të cilën kërkuan redaktimin e deklaratës si vijon: Midis shoqërisë “****” ShPK, e përfaqësuar nga N.B, dhe shtetasit Lorenc Shehu, është lidhur kontrata e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2008, ku, blerësi Lorenc Shehu porosit apartamentin nr. ***, në seksionin *, me sipërfaqe totale 103.41 m², nga të cilat, 6.59 m² ambiente të përbashkëta, kundrejt shumës 53.768 euro, nga të cilat, shuma 45.000 euro e likuiduar dhe shuma 8.768 euro do të likuidohej me mbarimin e punimeve. Meqenëse shoqëria ndërtuese nuk përfundoi punimet sipas dakortësimit, porositësi Lorenc Shehu investoi për përfundimin e punimeve shumën 870.000 lekë (e konvertuar në shumën 6.215 euro) sipas situacionit të firmës “****” ShPK. Gjithashtu, nga kësti i fundit është dhënë një kontribut për vendosjen e ashensorit, në shumën prej 2.500 euro sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.07.2015. Në vijim, deklaruesit, në cilësinë e përfaqësuesit të administratorit të shoqërisë “****”, deklarojnë se, në datën 31.07.2010 i kanë dorëzuar apartamentin z. Lorenc Shehu dhe se me përfundimin e punimeve që ka kryer të cilat kanë qenë detyrim për ti përfunduar nga shoqëria ndërtuese si dhe me dhënien e vlerës për vënien e ashensorit, është likuiduar plotësisht dhe nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj shoqërisë ndërtuese “****” ShPK.

- Certifikatë regjistrimi pronësie datë 03.08.2021, për pasurinë nr. ***, zk. 8330, e Llojit apartament, me sipërfaqe 102.82 m², e ndodhur në Tiranë, regjistruar në pronësi të Lorenc Gëzim Shehu. B/lidhur: Fragment i Hartës Kadastrale.
- Kartela e pasurisë nr. ***, zk. 8330, e Llojit apartament me sipërfaqe 102.82 m², e ndodhur në Tiranë, regjistruar në datën 03.08.2021 në pronësi të Lorenc Gëzim Shehu. Referuar informacionit mbi pronën, rezulton shënimi: “Leje legalizimi nr.***, datë 31.05.2021, godinë banimi dhe shërbimi 2,5,7 dhe 8 kat, me 1 kat nëntokë, kati 3-të, me sipërfaqe takuese shkalle 6.59 m²”.
- Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2018, me deklarues Lorenc Shehu dhe L.B, të cilët deklarojnë se, në dhjetor 2008, shtetasi Lorenc Shehu i ka marrë në dorëzim shtetasit L.B, shumën 20.000 euro, si hua pa interes, e marrë dorazi, pa nënshkruar asnjë marrëveshje apo akt noterial, dhe nga kjo vlerë i ka kthyer shtetasit L.B, vlerën monetare prej 12.000 euro, në shkurt 2014, e dhënë dorazi, pa nënshkruar asnjë marrëveshje apo akt noterial duke njohur si detyrim të shtetasit Lorenc Shehu ndaj shtetasit L.B, vlerën monetare prej 8.000 euro, me afat shlyerje brenda vitit 2022. Qëllimi i huamarrjes ka qenë blerja e një pasurie të paluajtshme e llojit shtëpi banimi, me sipërfaqe 103.4 m², e ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, ku aktualisht edhe jeton shtetasi Lorenc Shehu.
- Akt Marrëveshje për shkëmbimin në të ardhmen të sendit të ardhshëm, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.10.2022, me palë e parë Lorenc Shehu (jep pëlqimin Sofie Shehu) i cili disponon në pronësi pasurinë nr. ***, zk. 8330, e llojit apartament, me sipërfaqe 102.82 m², nga të cilat, 6.59 m² sipërfaqe të përbashkëta, ndodhur në Tiranë, me vlerë 125.000 euro, e kompletuar me mobilje dhe elektroshtëpiake etj., me palë të dytë shoqëria “****” ShPK, e pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Tiranë, për objekt banimi dhe shërbimi 4,6,8,10 dhe 12 kate, me 3 kate parkim nëntokë, ku do të ndodhet apartamenti nr. ***, H. ***, K. ***, në kuotën + *** të pallatit, me sipërfaqe 118.3 m² (sipas planimetrisë) me vlerë 125.000 euro. Palët kanë rënë dakord që të shkëmbejnë pasuritë e cituara si më sipër, pa kundër shpërblim apo diferenca në vlera ndërmjet tyre. Kontrata përfundimtare do të nënshkruhet pasi pala e dytë të ketë regjistruar pranë ASHK Tiranë, apartamentin objekt shkëmbimi. B/lidhur: Praktika.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE E A.M.P.

- ✚ ASHK me shkresën nr. *** prot., datë 30.08.2023, konfirmon se, Lorenc Gëzim Shehu rezulton i pajisur me leje legalizimi, sipas vendimit nr. ***, datë 30.06.2021, kati *** në Objekt 2,5, 7 dhe 8 + 1 kat nëntokë, Tirana Veri.
- ✚ ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri me shkresën nr. *** prot., datë 13.09.2023, konfirmon se, në pronësi të Lorenc Gëzim Shehu, rezulton pasuria e llojit apartament, me sipërfaqe 102.82 m², zk. 8330, vol. ***, faqe ***. B/lidhur praktikës:
Kartela e pasurisë nr. ***, zk. 8330, e llojit apartament, me sipërfaqe 102.82 m², e ndodhur në Tiranë, regjistruar në datën 03.08.2021, në pronësi të Lorenc Gëzim Shehu. Referuar informacionit mbi pronën, rezulton shënimi: “Leje legalizimi” nr. ***, datë 31.05.2021, godinë banimi dhe shërbimi 2,5,7 dhe 8 kat me 1 kat nëntokë, kati 3-të, me sipërfaqe takuese shkallë 6.59 m². Certifikatë regjistrimi pronësie datë 03.08.2021, për pasurinë nr. ***, zk. 8330, e llojit apartament, me sipërfaqe 102.82 m², e ndodhur në Tiranë, regjistruar në pronësi të Lorenc Gëzim

Shehu. B/lidhur: Fragment i Hartës Kadastrale. Vendim nr. ***, datë 31.05.2021, lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Veri, për legalizimin e ndërtimit pa leje, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit nr. *** prot., Numër Unik ***, në zk. 8330, poseduar nga Lorenc Gëzim Shehu.

- ✚ ASHK (online) konfirmon pasurinë nr. *** vol. ***, faqe ***, Zk. 8330, e ndodhur në Tiranë, në pronësi të Lorenc Gëzim Shehu, me status “mbyllur”, dhe përshkrim “Leje legalizimi” nr. ***, datë 31.05.2021, godinë banimi dhe shërbimi 2,5,7 dhe 8 kat, me 1 kat parkim nëntokë, kati i *** me sip. takuese shkallë 6.59 m².
- ✚ Banka Kombëtare Tregtare me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se, në llogari të Lorenc Shehu, rezulton llogari disbursimi i kredisë në shumën 1.000.000 lekë në 22.11.2017.
- Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti sqaroi se, apartamentin me sip. 102.82 m² e ka blerë sipas deklaramit duke likuiduar me para në dorë (cash) shumën 45.000 euro, në vitin 2008 dhe e ka marrë në dorëzim në vitin 2010, sipas dokumentacionit të paraqitur. Subjekti sqaroi se ka kryer punimet sipas situacionit të firmës “****”, datë 18.08.2010, punime të cilat kanë vijuar deri në vendosjen e ashensorit në vitin 2012 (paguar shuma 2500 euro sipas deklaratës noteriale dt. 04.07.2012) dhe për të cilat shuma 870.000 lekë është likuiduar pjesë-pjesë me para në dorë deri në vitin 2014, duke saktësuar se këtë apartament e ka përdorur për banim prej muajit janar 2018 dhe në vazhdim. Gjithashtu, sqaroi se, duke qenë në kushtet kur firma ndërtuese nuk finalizoi punimet dhe regjistrimin e pallatit në hipotekë, banorët e këtij pallati kanë aplikuar vetë për legalizimin e banesave dhe në vitin 2021 ka përfutuar certifikatën e regjistrimit të pasurisë sipas lejes së legalizimit dhe për këtë arsye, nuk disponon praktikën e aplikimit për legalizim (aplikim i cili është kryer në vitin 2021). Lidhur me burimin financiar, subjekti sqaroi se: për shumën 45.000 euro kanë shërbyer 20.000 euro huamarrje dhe 25.000 euro kursime nga të ardhurat familjare, për shumën 870.000 lekë të investuar sipas situacionit të paraqitur dhe për shumën 2.500 euro të likuiduar për vendosje ashensori, kanë shërbyer kursimet nga të ardhurat familjare. Gjithashtu, subjekti sqaroi se mobilimi i këtij apartamenti është kryer në vitin 2017 me burim financiar kredinë e disbursuar në BKT, me vlerë 1.000.000 lekë, për të cilat nuk disponon dokumentacion shtesë, duke saktësuar se vlera e apartamentit të mobiluar aktualisht është rritur në raport me vlerën e tregut dhe për këtë arsye sipas akt-marrëveshjes së shkëmbimit në të ardhmen, datë 13.10.2022, ka dakortësuar për ta shkëmbyer me një apartament me vlerë 125.000 euro, aktualisht në ndërtim në zonën e Selvisë në Tiranë, si dhe sqaroi se, në kushtet aktuale, duke e disponuar apartamentin sipas deklaramit, nuk ka kryer ende rivlerësim të pasurisë.

B/lidhur proces-verbalit të datës 27.3.2024, u administrua:

- Situacion punimesh nga “****”, datë 18.08.2010, për Objekt të ndodhur në Rr. “****”, Ap. nr. ***, në emër të Lorenc Shehu, në shumën totale për t'u likuiduar prej 870.000 lekë.
 - Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol, datë 04.07.2012, me deklarues N.B, si përfaqësues i shoqërisë “****” ShPK, i cili deklaroi se ka marrë shumën 2.500 euro nga shtetasi Lorenc Shehu, si këst i tretë në zbatim të kontratës së porosisë b/lidhur kësaj deklarate.
 - Kontratë kredie konsumatore datë 20.11.2017, me kredimarrës Lorenc Shehu dhe kredihënës BKT, për disbursimin e shumës 1.000.000 lekë për rregullim shtëpie, me afat shlyerje 60 muaj.
- B/lidhur praktikës: Plan pagesa me afat 22.11.2017 - 22.11.2022

34. Bazuar në deklaramin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se: Apartamentin me sip.

102.82 m², me vlerë 53.768 euro, subjekti e ka porositur në vitin 2008, duke likuiduar shumën prej 45.000 euro (me burim financiar huamarrje dhe kursime nga të ardhurat familjare dhe e ka marrë në posedim të pa përfunduar në vitin 2010. Ka kryer punimet e pakryera me vlerën e konvertuar prej 6.215 euro (likuiduar për periudhën 2010 - 2014) dhe ka paguar shumën 2.500 euro në vitin 2012, me burim financiar nga të ardhurat familjare. Ka mobiluar apartamentin me burim financiar kredinë me vlerë 1.000.000 lekë në vitin 2017 dhe ka filluar të banojë në këtë apartament prej vitit 2018 dhe në vijim.

35. Subjekti i vlerësimit në deklaratën e tij të pasurisë ka deklaruar se ka marrë një hua në vlerën monetare prej 20.000 euro kjo sipas deklaratës noteriale nr. *** rep, dhe nr. *** kol, të datës 27.04.2018 nga shtetasi L.B., Subjekti i vlerësimit z. Lorenc Shehu për shkak të pozicioneve që ka mbajtur në policinë e shtetit ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI që nga viti 2015. Me e-mailin e datës 09.07.2024 subjekti i vlerësimit u pyet se *“Ju jeni subjekt i deklarimit dhe kontrollit të pasurisë pranë ILDKPKI qysh nga viti 2015, deklarim para fillimit të detyrës, kjo edhe sipas materialit të dërguar nga ky inspektorat, pranë Trupës Vlerësuese të A.M.P. Gjithashtu keni deklaruar se nga shtetasi L.B, keni marrë borxh në Dhjetor 2008 shumën prej 20.000 euro pa interes dhe pa dokumentacion.*

A është deklaruar kjo shumë borxhi në deklarimin tuaj fillestar (pra 2015), si dhe sqaroni lidhjen që keni me këtë person”.

Në kthim përgjigjen e tij të datës 15.07.2024 protokolluar me tonën nr. *** subjekti sqaron se: *Shtetasin L.B, e kam mik familjar prej vitit 1990 dhe në vijim duke patur marrëdhënie të posaçme miqësore. Lidhur me shumën e marrë hua në v. 2008, sqaroj se duke mos patur dokumentacion noterial për huamarrjen dhe duke deklaruar në v. 2015 pasurinë e paluajtshme për të cilën kjo huamarrje ka shërbyer si burim i pjesshëm financiar, është menduar i ezauruar detyrimi për deklarim dhe në vijim, pas disponimit të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2018, është evidentuar marrëdhënia e huasë në deklaratën e interesave privatë të v. 2019 duke sqaruar kronologjikisht në kohë transaksionet monetare.*

36. Në arsyetimin e saj Trupa Vlerësuese vlerëson se:

- ✓ Subjekti i vlerësimit ka patur detyrim të deklarojë pranë ILDKPKI huanë e marrë në shumën prej 20.000 euro, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe prej 102.82 m² në adresën Rr. “****” nd. *** hy.* ap.***, Tiranë, qysh në momentin e parë të deklarimit, pavarësisht se është deklaruar pasuria e paluajtshme, por duhesh deklaruar edhe burimi i krijimit të saj dhe se nuk dispononte një akt noterial, apo formë tjetër të marrjes së huasë.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me apartamentin me sipërfaqe 102.82 m², me adresë: Rruga “****” dhe burimin financiar të krijimit, nga të cilat, 20.000 euro huamarrje dhe diferenca nga kursimet familjare. Huamarrja trajtohet më poshtë.
- ✓ Shpenzimet e mobilimit janë deklaruar me burim financiar kredinë e marrë në v. 2017, në BKT (trajtuar në vijim).

37. 3. **Llogari bankare në BKT, nr. 40269***, me balancë në datën 27.02.2023. Vlera:1.528 euro.** Burimi i krijimit: Të ardhura nga qiraja e banesës. Zotëron 100%. Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga BKT, printuar në datën 24.02.2023, për llogarinë e pagës në emër të Lorenc Shehu, me balancë 1.528 euro. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga qiraja për periudhën 10.12.2020 - 21.02.2023.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE E A.M.P.

- ✚ Banka Kombëtare Tregtare me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se, në emër të Lorenc Shehu, rezulton llogari rrjedhëse me balancë 1.528 euro, në datën 27.02.2023 dhe me balancë 1.526 euro, në datën 08.03.2023. Referuar statementit bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga qiraja për periudhën 10.12.2020 - 21.02.2023.
- ✓ Konstatohet: Llogaria në BKT është krijuar gjatë periudhës 2020 - 2023.
 - ✓ Konfirmohet llogaria e deklaruar në BKT.

38. 4. Llogari bankare në BKT, nr. 40269*, me balancë në datën 27.02.2023. Vlera: 3.027 lekë.** Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga. Zotëron 100%. Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga BKT, printuar në datën 27.02.2023, për llogarinë e pagës në emër të Lorenc Shehu, me balancë 3.027 lekë. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga për periudhën 26.04.2018 - 02.02.2023.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE E A.M.P.

- ✚ Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se, në emër të Lorenc Shehu, rezulton llogari rrjedhëse me balancë 3.027 lekë, në datën 27.02.2023 dhe 13.462 lekë, në datën 08.03.2023 (si dhe kartë krediti me limit 200.000 lekë). Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga për periudhën 02.07.2013 - 02.03.2023.
- ✓ Konstatohet: Llogaria në BKT është krijuar gjatë periudhës 2013 - 2023.
 - ✓ Konfirmohet Llogaria e deklaruar në BKT.

39. DEKLARIMI TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga puna si: Oficer Policie në Komisaratin e Policisë nr. 4; Komandant Poste Vorë në Komisaratin e Policisë nr. 4; Komandant i Grupit të Gatshëm në Komisaratin e Policisë nr. 4; Shef N/Seksioni Policisë Krye Kontrollor Rinas; Shef N/Seksioni Policisë së Rendit; Referent Inspektor Rendi në Komisaratin e Policisë nr. 4, për periudhat 25.08.1994 - 31.05.1995, 23.07.2003 - 09.03.2004 dhe 10.03.2004 - 31.01.2005, sipas vërtetimit të DVP Tiranë nr. *** prot., datë 20.04.2018. Shuma: 919.800 lekë. .
- Të ardhura nga puna si: Komandat N/reparti në Repartin 711 FNSH Tiranë; Komandat Grupi në Repartin 712 FNSH, për periudhat 01.06.1995 - 31.10.1997 dhe 01.01.2000 - 15.01.2000, sipas vërtetimit të Repartit N.SH. Tiranë. Shuma: 1.333.471 lekë.
- Të ardhura nga puna si Komandat Grupi në Repartin nr. 77, Tiranë dhe në dispozicion të Ministrisë së Rendit Publik, për periudhën 01.01.1997 - 31.12.1999, sipas vërtetimit datë 12.05.2009 të Ministrisë së Brendshme, paga të përfituara në shumën 995.217 lekë dhe për afërsisht duke shtuar taksën e solidaritetit dhe shpërblimet e përfituara në masën rreth 476.000 lekë. Shuma totale: 1.471.217 lekë.

- Të ardhura nga puna si Komandat Grupi dhe Instruktor në Repartin ROS Tiranë, për periudhën 16.01.2000 - 15.05.2001, sipas vërtetimit nr. ***, dt. 24.04.2018, të Repartit Renea Tiranë. Shuma totale: 1.085.731 lekë.
- Të ardhura nga puna si Komandat, Reparti Policisë nr. 324, Tiranë, për periudhën 16.07.2001 - 22.07.2003, sipas vërtetimit të Repartit të Sigurisë së Brendshme dhe Ceremonialit Tiranë, datë 12.04.2018. Shuma: 1.038.979 lekë.
- Të ardhura nga puna si Komandat Reparti të Rendit në Komisariatin e Policisë Mirditë, për periudhën 01.02.2005 - 31.12.2005, sipas vërtetimit të DVP Lezhë të pjesshëm dhe të përlllogaritur mbi këtë bazë page. Shuma: 632.489 lekë.
- Të ardhura nga puna si Komandat i Repartit të Rendit në Komisariatin e Policisë Mirditë, për periudhën 01.01.2006 - 10.12.2006; Shef i Seksionit të Rendit dhe Sigurisë Publike në Komisariatin e Policisë Kurbini, për periudhën 11.12.2006 - 14.10.2007; Shefi i Seksionit të Rendit dhe Sigurisë Publike në DPQ Lezhë, për periudhën 15.10.2007 - 09.09.2010, Shef i Sektorit të Rendit dhe Sigurisë Publike në DPQ Tiranë, për periudhën 10.09.2010 - 04.02.2014; Shef i Seksionit ai dhe Specialist në Seksionin e Sigurisë së Objekteve dhe Disiplinës në Sektorin e Administratës së Mbështetjes në Akademinë e Sigurisë Tiranë, për periudhën 05.02.2014 - 08.03.2015. Sipas vërtetimeve bankare, për periudhën 11.12.2006 - 08.03.2015 në Raiffeisen Bank, shuma 5.617.578 lekë, në Tirana Bank, shuma 3.567.877 lekë dhe në BKT, shuma 706.854 lekë. Shuma totale: 9.892.309 lekë.
- Të ardhura nga puna si Komandat Reparti në Repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë, për periudhën 09.03.2015 - 17.04.2018, sipas statement të BKT, shuma 2.358.264 lekë dhe sipas statement të Tirana Bank, shuma 2.203.059 lekë. Shuma totale: 4.561.323 lekë.
- Të ardhura si Komandat i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë, për periudhën 17.04.2018 - 04.07.2018. Shuma: 266.670 lekë.
- Të ardhura si Komandat i Repartit Special Renea, për periudhën 04.07.2018 - 30.09.2019. Shuma: 1.658.622 lekë.
- Të ardhura nga puna si Drejtor Vendor i Policisë Durrës, për periudhën 01.10.2019 - 05.07.2021. Shuma: 1.806.095 lekë.
- Të ardhura nga puna si Drejtor Vendor i Policisë Lezhë, për periudhën 16.07.2021 - 18.10.2021. Shuma: 349.096 lekë.
- Të ardhura si Drejtor i Qendrës së Mbyllur të Huajve në Karrec Tiranë, për periudhën 19.10.2021 - 31.01.2023. Shuma 1.378.007 lekë.
- Të ardhura nga qiraja, për periudhën 15.12.2019 - 15.05.2020, me qiramarrës S.D., sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2019 dhe Deklaratës Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.06.2020 (për anulimin e kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2019). Shuma: 291.840 lekë.
- Të ardhura nga qiraja, për periudhën 05.12.2020 - 27.02.2023, me qiramarrës A.M., sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.12.2020, sipas kontratës nr. *** rep., nr.*** kol., datë 03.02.2022, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2022. Shuma: 15.498 euro.

- Të ardhura nga shitja e automjetit tip Volkswagen Golf, vit prodhimi 2000, i blerë në Vitin 2011, me targa AA***CG, sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol., datë 12.12.2022. Shitur babait G .Sh . Shuma: 100.000 lekë.

40. Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 20.04.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura neto në shumën totale 919.800 lekë, për periudhat 25.08.1994 - 31.05.1995 dhe 23.07.2003 - 31.01.2005.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës Reparti NSH Tiranë, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto dhe shpërblime në shumën totale rreth 534.062 lekë, për periudhën qershor 1995 - tetor 1997.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës Ministrinë e Brendshme, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto në shumën totale rreth 995.217 lekë, për periudhën nëntor 1997 - dhjetor 1999.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës Reparti NSH Tiranë, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto dhe shpërblime në shumën totale 19.812 lekë, për periudhën 01.01.2000 - 15.01.2000.
- Vërtetim page nr. *** prot., datë 24.04.2018, lëshuar nga Reparti Special RENE A, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën totale neto 1.085.731 lekë, për periudhën 16.01.2000 - 15.05.2001.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.04.2018, lëshuar nga Reparti i Sigurisë së Brendshme dhe Ceremonialit, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën totale neto 1.038.979 lekë, për periudhën 16.07.2001-22.07.2003.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës DVP Lezhë, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto dhe shpërblime në shumën totale 172.497 lekë, për periudhën shkurt 2005 - prill 2005.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës Reparti NSH Tiranë, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto dhe shpërblime në shumën totale 3.353.950 lekë, për periudhën 09.03.2015 - 31.12.2017.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës Reparti NASH Tiranë, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto dhe shpërblime në shumën totale 3.838.204 lekë, për periudhën 09.03.2015 - 04.07.2018.
- Vërtetim page datë 24.04.2018, lëshuar nga Reparti Special RENE A, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën totale neto 1.658.662, për periudhën 09.07.2018 - 02.10.2019.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës DVP Durrës, ku vërtetohet se Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto dhe shpërblime në shumën totale 1.806.095 lekë, për periudhën 01.10.2019 - 05.07.2021.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, ku vërtetohet se, Lorenc Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto dhe shpërblime në shumën totale 1.378.008 lekë, për periudhën 18.10.2021 - 28.02.2023.

- Mandat tërheqje nga ProCredit Bank, dega Lezhë, datë 29.01.2008, për tërheqjen cash të shumës 320.500 lekë, me përshkrimin Çek nr. 0003***, tërhequr nga Lorenc Shehu.
- Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 17.04.2018, për klientin Lorenc Shehu, ku rezulton se, në llogarinë rrjedhëse janë kredituar dhe debituar shuma me vlerë totale rreth 6.696.615 lekë, për periudhën 2005 - 2017.
- Statement nga Tirana Bank, printuar në datën 11.04.2018, ku vërtetohet se, në Llogarinë e Lorenc Shehu janë kredituar të ardhurat nga paga dhe shpërblimet në shumën totale rreth 5.770.000 lekë, për periudhën 03.03.2011 - 04.10.2016.
- Statement nga BKT, printuar në datën 11.04.2018, ku vërtetohet se, në Llogarinë e Lorenc Shehu janë kredituar të ardhurat nga paga dhe shpërblimet: në shumën totale rreth 731.000 lekë, për periudhën 02.07.2013 - 26.12.2014, si dhe në shumën totale rreth 2.358.000 lekë, periudhën 25.10.2016 - 10.04.2018.
- Statement nga BKT, printuar në datën 27.02.2023, ku vërtetohet se, në Llogarinë e Lorenc Shehu janë kredituar të ardhurat nga paga dhe shpërblimet në shumën totale rreth 6.410.000 lekë, për periudhën 26.04.2018 - 02.02.2023.
- Statement nga BKT, printuar në datën 24.02.2023, ku vërtetohet se, në llogarinë e Lorenc Shehu është kredituar cash shuma totale rreth 15.500 euro, për periudhën 10.12.2020 - 21.02.2023.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 17.12.2019, me qiradhënës Lorenc Shehu, qiramarrës S.D., për dhënien me qira me afat 15.12.2019 - 15.12.2022 (5 vite), të pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, Zk 8360, e llojit apartament, me sipërfaqe 62.5 m², me adresë: Rr. “****” Tiranë. Vlera e qirasë: 400 euro/muaj, e cila do të likuidohet çdo 6 muaj në llogarinë bankare të palës qiradhënëse dhe për të cilën tatimi në burim në masën 15% merret përsipër nga pala qiradhënëse.
B/lidhur: Praktika.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.12.2020, me qiradhënës Lorenc Shehu, qiramarrës A.M., për dhënien me qira me afat 04.12.2020 - 04.12.2021 (1 vit), të pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk. 8360, e llojit apartament, me sipërfaqe 62.5 m², me adresë: Rr. “****” Tiranë. Vlera e qirasë: 500 euro/muaj, e cila do të likuidohet çdo muaj në llogarinë bankare të palës qiradhënëse dhe për të cilën tatimi në burim në masën 15% merret përsipër nga pala qiramarrëse.
B/lidhur: Praktika.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 03.02.2022, me qiradhënës Lorenc Shehu, qiramarrës A.M., për dhënien me qira me afat 04.12.2021 - 04.12.2022 (1 vit), të pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk. 8360, e llojit apartament; me sipërfaqe 62.5 m², me adrese: Rr. “****” Tiranë. Vlera e qirasë: 500 euro/muaj, e cila do të likuidohet çdo muaj në llogarinë bankare të palës qiradhënëse dhe për të cilën tatimi në burim në masën 15% merret përsipër nga pala qiramarrëse.
B/lidhur: Praktika.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2022, me qiradhënës Lorenc Shehu, qiramarrës A.M., për dhënien me qira me afat 4.12.2022 - 4.12.2023 (1 vit), të pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk. 8360, e lloji apartament, me sipërfaqe 62.5 m², me adresë: rr. “****” Tiranë. Vera e qirasë: 500 euro/muaj, e cila do të likuidohet çdo muaj në

- Ilogarinë bankare të palës qiradhënëse dhe për të cilën tatimi në burim në masën 15% , merret përsipër nga pala qiramarrëse. B/lidhur: Praktika,
- Kontratë shitje nr. *** rep., vnr. *** kol., datë 12.12.2022, me shitës Lorenc Shehu dhe blerës Gëzim Shehu, për shitjen e automjetit tip Volkswagen Golf me targë AA***CG nr. shasie WVWZZZIJZYB15***. Vlera 100.000 lekë.
 - Vërtetim datë 13.04.2018, lëshuar nga ***, ku vërtetohet se, në datë 23.12.2011 është depozituar kërkesa e palës kreditore Lorenc Shehu dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e vendimit nr. ***, datë 04.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënien në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. *** datë 15.11.2011, për shpërblim dëmi pasuror dhe jo pasuror në masën 7.757.530 lekë, nga debitori Shoqëria e Sigurimeve *** sha. Vendimi është ekzekutuar plotësisht pasi palës kreditore i ka kaluar shuma 7.305.105 lekë në llogarinë e tij në datën 13.08.2012 dhe në bazë të proces-verbalit kreditori ka marrë edhe shumën prej 400.000 lekë. B/lidhur: Statement transferimi fondesh nga Emporiki Bank, datë 13.08.2012, ku rezulton transferimi nga llogaria e *** ShPK, në llogari të Lorenc Shehu, i shumës 7.305.105 lekë, me përshkrimin “kalim për ekzekutim vendimi”.
 - ✚ Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon se, në emër të Lorenc Shehu rezulton llogari rrjedhëse me balancë 0 lekë, në datën 08.03.2023. Referuar statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga dhe shpërblimet në shumën totale rreth 325.000 lekë për periudhën 19.09.2005 - 05.01.2006 dhe në shumën totale rreth 5.255.000 leke për periudhën 18.01.2006 - 05.12.2011.
 - ✚ Banka Kombëtare Tregtare me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se në llogarinë në lekë në emër të Lorenc Shehu, rezulton kreditimi të ardhurave nga paga dhe shpërblimet në shumën totale rreth 9.601.000 lekë për periudhën 02.07.2013 - 08.03.2023; kreditimi i 291.840 lekë, në datën 17.12.2019, me përshkrimin “S.D., sipas kontratës së qirasë si dhe kreditimi i shumës 100.000 lekë, në datën 19.12.2022, me përshkrimin “G. Sh. sa derdh për Lorenc Shehu”.
 - ✚ Banka Kombëtare Tregtare me shkresën nr. 40/3 prot., datë 14.08.2023, konfirmon se në llogarinë në EUR në emër të Lorenc Shehu, rezulton kreditimi cash nga shtetasi A.M, në shumën totale rreth 14.500 euro, për periudhën 10.12.2020 - 21.02.2023 si dhe kreditimi cash i shumës 1.000 euro, në datën 24.11.2022, me përshkrimin “A.C. derdh në llogari të Lorenc Shehu”.
 - ✚ Tirana Bank me shkresën nr. *** prot., datë 28.07.2023, konfirmon se, në emër të Lorenc Shehu rezulton llogari rrjedhëse aktive për periudhën 2011 - 2018. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga dhe shpërblimet në shumën totale rreth 5.770.000 lekë, për periudhën 03.03.2011 - 04.10.2016 si dhe kreditimi me transfertë i shumës 700.000 lekë, në datën 23.07.2012, me përshkrimin “kalim për ekzekutim vendimi, nga G.S.”.
 - ✚ Banka Amerikane e Investimeve me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se, në emër të Lorenc Shehu, rezulton llogari kursimi në lekë, e hapur në datën 13.08.2012, me balancë të bllokuar 5.162 lekë prej datës 20.12.2016. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi me transfertë i shumës 7.305.105 lekë, në datë 13.08.2012, me përshkrimin “kalim nga *** ShPK, për ekzekutim vendimi”.

- ✚ DPSHTRR me shkresën nr. *** prot., datë 04.08.2023, konfirmon se, Lorenc Shehu ka patur të regjistruar në pronësi mjetin me targë AA***CG. B/lidhur:
- ✚ Kontratë për shitjen ndërmjetësuese nr. *** , datë 12.12.2011, me blerës Lorenc Shehu, shitës A.V.(Itali) dhe ndërmjetës B .Sh, për blerjen e automjetit tip Volkswagen Golf; me nr. shasje WVWZZZIJZYB15***, vlera 750 euro.
- ✚ Deklaratë doganore datë 10.12.2011, për importimin e mjetit tip Volkswagen Golf me nr. shasje WVWZZZIJZYB15*** vlera sipas faturës 750 euro, vlera statistikore 171.041 lekë, vlera e TVSH, 31.207 lekë.
- ✚ Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.12.2022, me shitës Lorenc Shehu dhe blerës G.SH, për shitjen e automjetit tip Volkswagen Golf me targë AA***CG dhe nr. shasje WVWZZZIJZYB15***, vlera 100.000 lekë.
- ✚ DRT Gjirokastrë, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se, Lorenc Shehu, me nr. ID H20727***C, figuron si administrator në Ente Publike, dhe përkatësisht: pranë Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë, për periudhën 11.02.2016 - 05.07.2018, pranë Drejtorisë së Policisë Durrës, prej datës 01.01.2019, pranë Njësisë Speciale RENE A Tiranë, për periudhën 05.07.2018 - 01.10.2019; dhe pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, për periudhën 13.07.2021 - 21.10. 2021.
- ✚ ISSH me shkresën nr. nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se për Lorenc Shehu janë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për pagën bruto dhe ka përfutuar të ardhura nga paga neto: nga subjekti “Drejtoria e Policisë” për periudhën janar 2012 - shkurt 2014 dhe për muajin janar 2015, nga subjekti “Qendra e Formimit Policor Tiranë” për periudhën shkurt 2014 - mars 2015; nga subjekti “Reparti i Ndërhyrjes së Shpejtë” për periudhën mars 2015 - korrik 2018; nga subjekti “RENEA” për periudhën korrik 2018 - tetor 2019; nga subjekti “DV Policisë Durrës” për periudhën tetor 2019 - korrik 2021; nga subjekti “Dr. Policisë së Qarkut Lezhë” për periudhën korrik 2021 - tetor 2021; nga subjekti “Departamenti për Kufirin dhe Migracionin” për periudhën tetor 2021 - qershor 2023.
- ✚ ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, i kërkon informacion Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.
- ✚ ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023, sqaron se, për periudhën 1994 - 2012, nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave të punonjësve të siguruar në subjekte shtetërore, juridik, fizik, nuk mund të konfirmohet periudha kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, n.q.s. nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasit për të cilët kërkohen të dhëna. B/lidhur: Vërtetim për vjetërsinë në punë për efekt pensioni.
- ✚ D.R.T Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 01.11.2023, konfirmon se, Lorenc Gëzim Shehu, i dt. 27.07.1972, figuron i regjistruar për përgjegjësinë tatimore tatim në burim (tatim mbi qiranë) dhe ka kryer deklarime dhe pagesa për të cilat nuk mund të përcaktohet se cilës kontratë qiraje i përkasin. Referuar të dhënave, rezulton se, për periudhën Nëntor 2022 – Mars 2023, subjekti ka deklaruar qira me vlerë totale 1.082.614 lekë, për të cilën është paguar tatim mbi qiranë në shumën totale rreth 162.391 lekë.

41. Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti ka sqaruar se, në vitet 1997 - 2001 ka përfituar të ardhura nga detyrat në strukturat e forcave speciale në formën e shpërblimeve dhe si pagesë solidariteti, për të cilat nuk disponon dokumentacion të plotë, duke konfirmuar të ardhurat nga paga sipas transaksioneve bankare. Gjithashtu, sqaroi se, shuma 320.500 lekë, sipas mandat tërheqjes nga ProCredit Bank, datë 29.01.2008, për tërheqjen cash të shumës 320.500 lekë, me përshkrim “Çek nr. 0003***, tërhequr nga Lorenc Shehu”, është dëmshpërblimi nga siguracioni për automjetin me targë AM***EW, deklaruar në seksionin e të dhënave konfidenciale në formular, si dhe sqaroi se, duke e deklaruar si burim financiar për krijimin e asetëve të paluajtshme, e ka menduar të ezauruar detyrimin për deklarim të ardhurave nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, duke saktësuar se shuma totale është përfituar sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe konkretisht shuma 400.000 lekë e përfituar cash dhe shuma 7.305.105 lekë e përfituar sipas transaksionit bankar, si dhe pavarësisht shënimeve në statement bankar, shuma 700.000 lekë e përfituar në datën 23.07.2012 nga G.S, sipas transaksionit, është marrë si parapagim personal për nevoja të momentit dhe është kthyer cash në momentin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, për të cilin nuk disponon dokumentacion shtesë. Gjithashtu, subjekti sqaroi se ka patur shpenzime për trajtim shëndetësor në Gjermani, pas aksidentit automobilistik në gusht 2008, sipas vendimit gjyqësor me vlerë rreth 900.000 lekë, për të cilat nuk disponon dokumentacion të plotë lidhur me shumën e paguar, e cila është përballuar me burim financiar nga kursimet familjare nga të ardhurat në vite. Lidhur me të ardhurat nga qiraja, subjekti ka konfirmuar sipas deklarimit duke sqaruar se tatimi në burim për kontratën e datës 17.12.2019 është kryer nga ana e tij sipas dokumentacionit të cilin po e paraqet ndërsa, tatimi në burim për kontratat në vijim është përcaktuar si detyrim i palës qiramarrëse dhe në dijeninë e tij është paguar sipas përcaktimeve ligjore, duke konfirmuar se pavarësisht afatit 5-vite, kontrata e qirasë datë 17.12.2019 është anuluar, sipas deklaratës noteriale datë 05.06.2020.

42. B/lidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024 u administrua:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë 05.06.2020, me deklarues Lorenc Shehu dhe S.D., për anulimin e kontratës së qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2019, pasi marrëdhënia e qirasë është ndërprerë në datën 15.05.2020, pa pretendime në të ardhmen. B/lidhur: Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2019.
- Deklarata individuale vjetore e të ardhurave, për periudhën tatimore 19-A, për Lorenc Shehu me nr. ID: H2072***K, i cili ka deklaruar të ardhura nga qiraja në shumën 291.000 lekë, nga të cilat, tatimi i llogaritur për t'u paguar me vlerë 43.650 lekë.
B/lidhur: Mandat pagesa nga BKT, datë 14.12.2023, për shlyerjen e detyrimit tatimor DIVA 2019, me vlerë 44.624 lekë, në favor të D.P. Tatimeve.
- Mandat pagesa nga BKT, datë 27.02.2024, për shlyerjen e detyrimit tatimor DIVA 2019, me vlerë 24.192 lekë, në favor të D.P. Tatimeve.
- Statement bankar nga Credins Bank, për llogarinë në emër të A.M., ku rezulton debitimi i tatimit të mbajtur në burim me vlerë totale rreth 102.670 lekë, për periudhën 20.01.2023 - 26.10.2023.
- Mandat pagesa në Credins Bank, datë 20.12.2022, për transferimin nga A.M, të shumës 121.323 lekë, me përshkrimin “tatim i mbajtur në burim”.

- Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 15.11.2011, me paditës Lorenc Shehu dhe i paditur *** sha, ku është vendosur: Lënia në fuqi e Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. ***, datë 04.03.2011 (ku, ndër të tjera, është vendosur: dëmshpërblimi i paditësit Lorenc Shehu në shumën 7.757.530 lekë.
- Vendim i Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 12.07.2012, me paditës Lorenc Shehu dhe i paditur *** sha, ku është vendosur: Mospranimi i rekursit të paraqitur nga pala e paditur, kundër Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. ***, datë 15.11.2011.
- ✓ Të ardhurat neto të subjektit nga paga, dietat dhe shpërblimet, për periudhën gusht 1994 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 23.176.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e subjektit nga qiraja, për periudhën dhjetor 2019 - mars 2023, konfirmohen në vlerën rreth 2.774.000 lekë.
- ✓ Gjithashtu, subjekti ka përfituar të ardhura nga ekzekutim vendimi gjyqësor, në vitin 2012 në shumën totale rreth 7.705.000 lekë.
- ✓ Subjekti ka kryer shpenzime për trajtim shëndetësor, në shumën totale rreth 900.000 lekë, pas aksidentit automobilistik në v. 2008.

43. **DETYRIME FINANCIARE**

- Kredi në BKT, me bashkë kredimarrës b/shorten, në shumën e disbursuar 6.000.000 lekë, me datë fillimi 27.01.2021, me afat 120 muaj dhe kolateral apartamentin, me adresë: Rruga "****", Pallati ***, Hyrja ***, Apartamenti ***, Kodi Postar 1016, Njësia nr. 9, Tiranë, sipas kontratës së hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.01.2021.
- Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.01.2021. Mbyllja e dy kredive në një kredi të vetme, nga të cilat: njëra në ABI Bank (marrë në v. 2014) ndërsa tjetra në BKT (marrë në v. 2018).
 1. Kredi bankare në BKT, për rregullim dhe arredim të shtëpisë ku banoj, disbursuar në datën 22.11.2017, në shumën 1.000.000 lekë, me afat 5 vite, me këst 20.299 lekë/muaj, sipas plan kontratës fillestare (b/lidhur).
 2. Kredi bankare në NBG Bank, disbursuar në shumën 20.000 euro, në datën 20.01.2014, me afat 20 vite, me këst 150.69 euro/muaj. Gjendje në datën 16.04.2018, shuma 17.737 euro, sipas vërtetimit bankar. Sqaroj se këtë kredi e mora në emër të kunatës M.SH., por këstet dhe të gjitha detyrimet bankare paguhen dhe mbulohen nga ana ime. Nga kjo kredi kam likuiduar shumën 12.000 euro shtetasit L.B, në shkurt 2014, dhe pjesën tjetër prej 8.000 euro ja kam akoma hua për pamundësi likuidimi, vërtetuar sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2018 nga shtetasi L.B.,
- Qëllimi: Shlyerje kredie si dhe ndjekje studimesh për shkollimin e fëmijëve dhe blerje makine. Shuma e detyrimit të mbetur pa shlyer për shlyerje të dy kredive është vlera 2.006.931 lekë. Shuma e detyrimit të mbetur pa shlyer për shkollimin e vajzës është në vlerën 1.103.608 lekë. Shuma totale e detyrimit financiar: 3.110.539 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë kredie nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 27.01.2021, me kredimarrës Lorenc Shehu dhe Sofie Shehu, kredihënës BKT, për disbursimin e kredisë në shumën 6.000.000 lekë, me qëllim mbyllje kredie ekzistuese në ABI Bank dhe pjesa e mbetur për blerje makine si dhe shpenzime edukimi. Shuma e parë për t'u disbursuar me vlerë 2.450.000 lekë do të përdoret për likuidimin e kredisë së shtetasës M.SH. pranë ABI

Bank. Shuma e dytë prej 3.550.000 lekë do të disbursohet pas likuidimit të kredisë ne ABI Bank dhe kjo shumë do të përdoret për blerje makine dhe shpenzime edukimi. Sigurimi i kredisë, nëpërmjet hipotekimit të pasurisë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk 8360, e llojit apartament, me sipërfaqe 62.5 m², me adrese: Rr. “****”, H. ***, AP.***, Tiranë, në pronësi të Lorenc Shehu.

- Vërtetim nga BKT, me nr. *** prot., datë 27.02.2023, ku vërtetohet se Lorenc Shehu është klienti i bankës dhe disponon dy kredi me gjendje detyrimi financiar në shumën totale 3.110.539 lekë dhe përkatësisht: kredia 1- 2.006.931 lekë dhe kredia 2- 1.103.608 lekë.
- Raporti i kreditorit datë 11.04.2018, lëshuar nga Banka e Shqipërisë, ku vërtetohet se, shtetasi Lorenc Shehu disponon.
 1. Kredi datë 05.10.2005, në shumën e disbursuar 167.028 lekë, aktualisht e likuiduar.
 2. Kredi datë 17. 01. 2013, në shumën e disbursuar 200.000 lekë, aktualisht e likuiduar.
 3. Kredi datë 26.08.2014, në shumën e disbursuar 161.703 lekë, aktualisht e likuiduar.
 4. Kredi datë 22.11.2017, në shumën e disbursuar 1.000.000 lekë, me këst 16.666 lekë/muaj nga e cila ka gjendje detyrimi shumën 943.346 lekë.
 5. Kredi (person i lidhur) datë 20.01.2014, në shumën e disbursuar 20.000 euro, me gjendje detyrimi shumën 17.849 euro.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.04.2018, me deklarues M.SH. e cila konfirmon se ka përfituar kredi nga NBG Bank, me vlerë 20.000 euro, sipas kontratës nr.*** rep., nr. *** kol., datë 07.01.2014, me dorëzanës kunatin Lorenc Shehu, pasi ai nuk plotësonte kushtet për të marrë kredi duke deklaruar se kjo kredi e disbursuar në të vërtetë është për dorëzanësin Lorenc Shehu për shlyerje borxhi dhe nevoja financiare familjare dhe shtetasi Lorenc Shehu ka kryer te gjitha pagesat e kushteve që nga momenti i disbursimit të kredisë dhe ka të gjitha detyrimet e barrës së kredisë me këtë bankë.

✚ Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se në emër të Lorenc Shehu, rezulton llogari kredie me gjendje detyrimi 3,084.167 lekë, në datën 08.03.2023. Referuar në statement bankar, rezulton: disbursimi i kredisë në shumën 1.000.000 lekë, në datën 22.11.2017; disbursimi i kredisë në shumën 2.450.000 lekë, në datën 05.02.2021 dhe debitimi me transfertë i shumës 1.994.768 lekë, në favor të ABI Bank, në datën 08.02.2021, me përshkrimin “Lorenc Shehu, kalim për mbyllje kredie në emër të M.SH.”, disbursimi i kredisë në shumën 1.260.000 lekë, në datën 27.08.2021 dhe debitimi i shumës 1.260.000 lekë, në datën 27.08.2021, në favor Sonja Shehu, me përshkrimin “kalim për aplikim për vizë, ambasada Gjermane, për studime”.

✚ Banka Amerikane e Investimeve me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se: Lorenc Shehu figuron b/mbajtës në llogarinë rrjedhëse ne EUR, e hapur në datë 26.12.2013 dhe e mbyllur në datë 18.06.2021, me titullar M.SH., e cila ka marrë një kredi hipotekare me vlerë 20.000 euro, me afat 20 vite, me garantor Lorenc Shehu dhe Sofie Shehu, e mbyllur në datën 12.02.2021. Referuar në statement bankar, rezulton disbursimi i kredisë në shumën 20.000 euro, në datën 20.01.2014, debitimi me transfertë i shumës 19.800 euro, më datë 21.01.2014, me përshkrim “****” ShPK, likuidim apartamenti transfertë sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2013, si dhe depozitimi cash, kryesisht nga Lorenc Shehu, i kësteve të kredisë, me vlerë totale rreth 13.100 euro për periudhën 26.02.2014 - 12.02.2021 si dhe

kreditimi me transfertë i shumës 16.125 euro, më datë 12.02.2021, me përshkrim: “Lorenc Shehu, kalim për mbyllje kredie”.

- Në proces-verbalin e datës 27.03.2024. subjekti ka konfirmuar kreditë (overdraft) me vlera minimale për shpenzime konsumi, të disbursuara dhe të likuiduara për periudhën 2005 - 2014, sipas dokumentacionit të dorëzuar nga Banka e Shqipërisë, por të cilat nuk disponon dokumentacion shtesë, ka konfirmuar se ka marrë kredi në shumën 1.000.000 lekë, në vitin 2017, për mobilim apartamenti dhe ka konfirmuar se kunata M.SH., për llogarinë e tij, ka marrë kredinë në shumën 20.000 euro, me qëllim shlyerjen e një pjese të huasë së marrë shtetasit L.B, dhe diferencën për shpenzime konsumi, për të cilin detyrimet janë paguar sipas transaksioneve bankare dhe dokumentacionit të paraqitur. Lidhur me transaksionet në llogarinë e shtetasit M.SH., subjekti sqaroi se nuk disponon informacion të plotë por paraqet deklaratën datë 18.02.2014, nga *** ShPK, duke konfirmuar se shumën e marrë kredi nga kunata, e ka përfituar në dore (cash). Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar se ka marrë kredi me limit 6.000.000 lekë, nga të cilat ka disbursuar shumën 2.450.000 lekë, në datë 05.02.2021, me destinacion mbyllje kredie në ABI Bank (në emër të kunatës M.SH.) dhe ka disbursuar shumën 1.260.000 lekë, në datën 27.8.2021, me destinacion përballimin e shpenzimeve të studimit të vajzës, Sonja Shehu, në Gjermani, duke disponuar akoma limit kreditimi me qëllim blerje makine sipas kontratës së kredisë, e cila nuk është përdorur ende.
B/lidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024, u administrua: Kontratë kredie konsumatore datë 20.11.2017, me kredimarrës Lorenc Shehu dhe kredidhënës BKT, për disbursimin e shumës 1.000.000 lekë për rregullim shtëpie, me afat shlyerje 60 muaj.

B/lidhur praktikës: Plan pagesa me afat 22.11.2017 – 22.11.2022.

- Deklaratë datë 18.02.2014, nga “****” ShPK, e përfaqësuar nga ortakut dhe administratori A.S, i cili deklaroi se, kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 04.12.2013, lidhur me M.SH. dhe shoqërisë “****” ShPK, për të cilën është likuiduar shuma 19.800 euro, është revokuar dhe shuma 19.800 euro i është kthyer cash palës blerëse në zyrat e shoqërisë, sot, në datën 18.02.2014.
- Kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.01.2014, me kredidhënës NBG Bank Albania, me kredimarrës M.SH. dhe dorëzues Lorenc Shehu, për disbursimin e shumës 20.000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti, me kolateral pasurinë nr. ***, vol. ***, faqe ***, zk. 8360, e llojit apartament, me sipërfaqe 62.5 m², i ndodhur në Rrugën e ***, Tiranë, regjistruar në pronësi të shtetasit Lorenc Shehu.
- Certifikatë familjare datë 26.03.2024 (për gjendjen familjare të v. 1995) me kryefamiljar B. Sh dhe anëtarë të familjes H. Sh. (b/shortja), S. Sh (i biri), S. Sh. (e bija) dhe M.SH. (e bija).
Konstatohet se; Subjekti ka marrë kredi në BKT në v. 2021, me limit 6.000.000 lekë, nga të cilat ka disbursuar shumën 2.450.000 lekë, me destinacion shlyerjen e detyrimeve të kredisë ekzistuese në BKT dhe kredisë së marrë në v. 2014, në ABI Bank, nga M.SH. (përdorur nga subjekti), si dhe shumën 1.260.000 lekë, me destinacion mbulimin e shpenzimeve për shkollimin e vajzës Sonja Shehu, në Gjermani. Diferenca nga limiti i kredisë nuk është disbursuar.

Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me kreditë e disbursuara në vite.

- Detyrim në shumën monetare 8.000 euro, ndaj shtetasit L.B., për huamarrjen sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë 27.04.2018, nga shtetasi L.B.. Shuma e detyrimit financiar: 8.000 euro.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2018, me deklarues Lorenc Shehu dhe L.B, të cilët deklarojnë se në dhjetor 2008, shtetasi Lorenc Shehu i ka marrë në dorëzim shtetasit L.B, shumën 20.000 euro, si hua pa interes, e marrë dorazi pa nënshkruar asnjë marrëveshje apo akt noterial dhe nga kjo vlerë i ka kthyer shtetasit L.B, vlerën monetare prej 12.000 euro, në shkurt 2014, e dhënë dorazi pa nënshkruar asnjë marrëveshje apo akt noterial duke njohur të detyrim të shtetasit Lorenc Shehu ndaj shtetasit L.B, vlerën monetare prej 8.000 euro, me afat shlyerje brenda vitit 2022. Qëllimi i huamarrjes ka qenë blerja e një pasurie të paluajtshme e llojit shtëpi banimi, me sipërfaqe 103.4 m², e ndodhur në Rr. ***, Tiranë, ku aktualisht edhe jeton shtetasi Lorenc Shehu.

44. Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti ka konfirmuar sipas deklaramit, duke sqaruar se si burim financiar për shumën e marrë hua kanë shërbyer të ardhurat e shtetasit L.B, nga kontratat të cilat po i paraqet. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se, pavarësisht citimit në deklaratën noteriale, për shkak të pamundësisë financiare dhe të marrëdhënieve të miqësisë me palën huadhënës, detyrimi i mbetur prej 8.000 euro nuk është shlyer deri në vitin 2022, duke u shtyrë shlyerja pa afat, me dakortësim verbal mes palëve, për të cilën nuk disponon dokumentacion shtesë duke konfirmuar se huaja është e pandryshuar deri ditën e sotme.

45. Bashkëlidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024, u administrua:

- Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.08.2007, me sipërmarrës dhe investitor Ferdinant Brahimi dhe porositës L.B., ku palët bien dakord se pala sipërmarrëse do ti japë palës pronare të truallit z. L.B., shumën 100.000 euro, deri në datën 05.08.2007, si dhe ambientet si vijon: dyqan me sip. 62.6 m², dyqan me sip. 61.7 m², dyqan me sip. 57.8 m², dyqan me sip. 41.1 m², dyqan me sip. 58.7 m², dyqan me sip. 60.2 m², dyqan me sip. 60 m², dyqan me sip. 48.34 m², dyqan me sip. 69.3 m², dyqan me sip. 60.22 m² dhe tre garazhe.
- Kontratë premtim shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.10.2007, me palë premtuese të shitjes L.B, me palë blerëse L.R, për premtimin e shitjes së dyqanit me sipërfaqe 48.34 m², me vlerë 55.000 euro, nga të cilat, shuma 25.000 euro është likuiduar me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe diferenca prej 30.000 euro do të likuidohet deri në tetor 2008.
- Kontratë premtim shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.2007, me palë premtuese të shitjes L.B, me palë blerëse F.K, për premtimin e shitjes së dyqanit me sipërfaqe 41.1 m², me vlerë 102.750 euro, nga të cilat, shuma 15.000 euro likuidohet me nënshkrimin e kësaj kontrate, shuma 30.000 euro do të likuidohet brenda datës 30.12.2008, shuma 20.000 euro do të likuidohet brenda vitit 2009, shuma 20.000 euro do të likuidohet brenda vitit 2010, dhe diferenca prej 17.750 euro do të likuidohet brenda vitit 2011.
- Kontratë premtim shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.10.2008, me palë premtuese të shitjes L.B, me palë blerëse S.Q, për premtimin e shitjes së dyqanit me sipërfaqe 62.6 m², me vlerë 188.000 euro, nga të cilat, shuma 30.000 euro likuidohet me nënshkrimin e kësaj kontrate, shuma 25.000 euro do të likuidohet brenda datës 30.01.2009, shuma 25.000 euro do të likuidohet brenda datës 30.05.2005, shuma 25.000 euro do të likuidohet brenda datës 31.12.2009, shuma 19.500

euro do të likuidohet brenda datës 30.05.2010 dhe diferenca prej 63.500 euro do të shkëmbehet me një apartament që znj. S.Q. ka porositur tek shoqëria “****” ShPK, me sip. 63.5 m².

- Kontratë premtim shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 05.12.2008, me palë premtuese të shitjes L.B, me palë blerëse P. Xh. dhe F. Xh, për premtimin e shitjes së dyqanit me sipërfaqe 69.3 m², me vlerë 124.740 euro, nga të cilat, shuma 50.000 euro likuidohet me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe diferenca prej 74.740 euro do të likuidohet brenda vitit 2009.
 - ✓ Kontratë premtim shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.01.2009, me palë premtuese të shitjes L.B., me palë blerëse I.G, për premtimin e shitjes së dyqanit me sipërfaqe 58.7m², me vlerë 193.710 euro, nga të cilat, shuma 180.000 euro likuidohet me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe diferenca prej 13.710 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitjes.
 - Konstatohet: Për huanë në shumën 20.000 euro, të marrë në v. 2008, për blerje pasurie të paluajtshme (apartament në Rr. "****", Tiranë), subjekti ka shlyer pjesërisht shumën 12.000 euro në v. 2014, me burim financiar nga kredia e disbursuar në emër të M.SH. (kunata e subjektit) në ABI Bank, dhe ka detyrim financiar të pashlyer shumën 8.000 euro.
 - ✓ Konfirmohet deklarimi me sqarimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur lidhur me huamarrjen dhe burimin financiar të palës huadhënëse.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

46. Të vitit të fundit kalendarik për qira banese ujë drita, telefon dhe internet si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur. Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.
- Shpenzime për ujë për vitin 2022, me kontratë nr. 1494****, në vlerën 29.238 lekë.
 - Shpenzime për OSHEE për vitin 2022, me kontratë nr. TR2D02018818****, në vlerën 89.538 lekë.
 - Shpenzime telefonike për vitin 2022, për numrin 06941****, në vlerën 8.257 lekë.
 - Shpenzime telefonike për vitin 2022, për numrin 06964****, në vlerën 21.073 lekë.
 - Shpenzime telefonike për vitin 2022, për tre nr. e telefonave familjarë (b/shortja dhe dy vajzat), në vlerën totale rreth 37.000 lekë.
 - Shuma Totale e Shpenzimeve: 185.107 lekë.
 - Për sa i përket kontratës së dritave nr. TR2A1 1005801****, kontratës së ujit nr. 126****, kontratës së internetit në emër të Lorenc Shehu, si dhe të gjitha detyrimeve të tjera, paguhen nga qiramarrësi sipas kontratës së qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2022 dhe i përkasin shtetasit A.M.,
47. Bashkëlidhur deklaratës: Tabelë përmbledhëse e pagesave për konsumatorin me kontratë nr. TR21A02018818****, në emër të klientit Lorenc Shehu, ku vërtetohet pagesa e faturave për furnizim me energji elektrike për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, me vlerë totale rreth 89.538 lekë.
- Printim nga sistemi i pagesave për konsumatorin me kontratë nr. 1494****, me adresë Rruga ****, abonent Lorenc Shehu, ku vërtetohet pagesa e faturave për furnizim me ujë për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, me vlerë totale rreth 29.238 lekë.

Tabelë përmbledhëse e pagesave telefonike në emër të abonentit Lorenc Shehu me nr. tel: 06941***, ku vërtetohet pagesa e faturave për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, me vlerë totale rreth 8.257 lekë.

48. Tabelë përmbledhëse e pagesave telefonike në emër të abonentit Lorenc Shehu me nr. tel: 06964***, ku vërtetohet pagesa e faturave për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, me vlerë totale rreth 21.073 lekë.

✚ FSHU me shkresën nr. *** prot., datë 4.8.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Lorenc Gëzim Shehu nuk rezultojnë abonentë me kontrata furnizimi, ndërsa, me gjeneralitetet Lorenc Shehu identifikohen 5 abonentë me kontratë furnizimi për energji elektrike, dhe përkatësisht:

1. Kontrata datë 18.01.2009, Konsumatori nr. TR2D02018818***, “Familjar Ap”, adresa: “***”, Tiranë.
2. Kontrata datë 10.05.2005, Konsumatori nr. TR2A11005801***, “Familjar Ap”, adresa: ‘***’, Tiranë.
3. Kontrata datë 07.11.2008, Konsumatori nr. BEOF03008015***, Kategoria “Familjar përdhes” adresa “Sulzotaj Fshat” Lushnje
4. Kontrata datë 30.04.2010, Konsumatori nr. GJ1K01004503***, Kategoria “Familjar përdhes” adresa Gjirokastër.
5. Kontrata datë 22.11.2012, Konsumatori nr. FIOA17005930***, Kategoria “Familjar përdhes”, adresa Vlorë.

✚ 15- Shoqëri Rajonale të Ujësjetllës - Kanalizime me shkresat nr. *** prot., datë 31.07.2023 deri në 17.08.2023, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

✚ Vodafone Albania sha me shkresën nr. *** prot., datë 03.11.2023, konfirmon se: në emër të Lorenc Shehu, rezultojnë katër numra telefonikë me status “inaktivë”, para vitit 2022 si dhe gjashtë numra telefonikë me status “aktive”, gjatë vitit 2022, për të cilët janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 85.000 lekë për vitin 2022; në emër të Repartit Special Renea (co' Lorenc Shehu) rezulton një numër telefonikë me status 'aktive', për të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 7.560 lekë për vitin 2022; si dhe në emër të Sofie Shehu rezulton një numër telefonike me status “aktive” për të cilin janë paguar detyrimet me vlerë totale rreth 6.500 lekë për vitin 2022. Gjithashtu, konfirmohet se, në emër të Lorenc Shehu rezulton kontratë e telefonisë fikse dhe/ose internet për të cilën janë paguar detyrimet totale rreth 14.600 lekë për vitin 2022.

✚ One Albania sha, me shkresën nr. *** prot., datë 24.8.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

✚ Albania Satelitë Communications ShPK me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

✚ Abissnet sha me shkresën nr. *** prot., datë 04.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

✚ Digicom sha, me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022.

Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti ka konfirmuar kontratën e furnizimit me energji elektrike të lidhur në datën 18.01.2009, e cila i përket apartamentit të deklaruar me sip. 102.82 m², duke sqaruar se nuk disponon dokumentacion shtesë lidhur me kontratën fillestare, ka konfirmuar kontratën e furnizimit me energji elektrike të lidhur në datë 03.02.2014, sipas

përshkrimin në konfirmimin e FSHU për kontratën fillestare, datë 10.05.2005, e cila i përket apartamentit të deklaruar me sip. 62.5 m². Gjithashtu, subjekti sqaroi se, nuk i konfirmon kontratat e tjera të rezultuara sipas përgjigjes së FSHU në instancat Vlorë, Lushnje dhe Gjirokastrë, të cilat deklaroi se nuk i përkasin. Lidhur me shpenzimet për pagesa të energjisë elektrike dhe për ujë të pijshëm, subjekti konfirmoi sipas dokumentacionit të paraqitur, duke sqaruar se detyrimet e kontratës nr. ***, për furnizim me energji elektrike dhe të kontratës nr. 126***, për furnizimin me ujë të pijshëm si dhe shpenzimet e internetit të banesës me sip. 62.5 m², i paguan pala qiramarrëse. Lidhur me shpenzimet për numrat e telefonit, subjekti konfirmoi sipas përgjigjes së kompanisë Vodafone Albania duke sqaruar se dy nga numrat e rezultuara në emrin e tij janë në përdorim të familjarëve, si dhe duke sqaruar se në momentin e plotësimit të formularit nuk ka disponuar dokumentacionin e plotë.

Në lidhje me shpenzimet e konfirmuara nga Vodafone Albania, për kontratën e telefonisë fikse dhe/ose internet, subjekti sqaroi se kjo kontratë i përket apartamentit me sip. 62.5 m², detyrimet e të cilës paguhen nga pala qiramarrëse dhe për këtë arsye nuk janë evidentuar në formular.

B/lidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024, u administrua:

- Vërtetim nga shoqëria *** ShPK, datë 04.07.2013, për ndryshimin e kontratave për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike nga klienti N.B. në Lorenc Shehu, duke vërtetuar se, apartamenti me nr. pasurie *** në Rr. ***, Tiranë, është në pronësi të shtetasit Lorenc Shehu.
- Kopje e librezës nga FSHU, për kontratën nr. A/1***.
- Kopje e librezës nga UKT sha, për kontratën nr. 126***.
- ✓ Shpenzimet e subjektit dhe të personave të lidhur për ujë, drita, telefon dhe internet, gjatë periudhës 01.01.2022 - 31.12.2022, rezultojnë në total rreth 205.000 lekë. Sa i përket shpenzimeve për furnizimin me energji elektrike, ujë dhe internet të banesës në Rr. "****", subjekti ka sqaruar se likuidohen nga pala qiramarrëse. Ka paraqitur librezat përkatëse.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me deklarin dhe përgjigjet e Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe Vodafone Albania sha.
 - Udhëtim për në Prishtinë (Kosovë), për arsye mjekësore, në datën 04.10.2022, kur kanë udhëtuar Lorenc Shehu, Sofie Shehu dhe Sonja Shehu, nëpërmjet pikës kufitare të Morinës dhe kthyer në të njëjtën datë 04.10.2022. Shuma e shpenzuar: 150 euro.
 - Udhëtim në Milano (Itali), të ftuar nga H.Z. (daja) dhe fëmijët e tij, në datën 18.02.2023, kur kanë udhëtuar Lorenc Shehu, Sofie Shehu, Venera Shehu dhe Aleks Shehu. Kthimi në datën 23.02.2023 (ora 1:12). Biletat e udhëtimit, akomodimi dhe qëndrimi u siguruan nga daja dhe fëmijët e tij (E.Z. dhe I.Z.). Shuma e shpenzuar: 350 euro.
 - Udhëtimet e Sonja Shehu (vajza), si studente në vitin e dytë në Universitetin e Magdeburg-ut, në Gjermani. Në të gjitha udhëtimet, biletat kanë qenë low cost dhe janë prerë me linjën Wizz Air, kurse biletat e trenit me kompaninë Deutsche Bahn. Çmimet për avionin, trenin dhe valixhet janë mesatarisht 70 euro/udhëtim. Shuma e shpenzuar: 700 euro.
 - Dalje në datat: 07.10.2021; 24.11.2021, 14.01.2022; 31.03.2022; 11.05.2022; 21.06.2022; 06.10.2022; 30.11.2022, 09.01.2023.
 - Hyrje në datat: 18.11.2021; 25.12.2021; 24.02.2022; 06.05.2022; 16.06.2022; 11.08.2022; 25.11.2022, 19.12.2022; 23.02.2023.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Shkresa nr. *** prot., datë 27.02.2023, lëshuar nga Ministria e Brendshme, ku vërtetohet se, shtetasit Lorenc Shehu, Sofie Shehu dhe Sonja Shehu, kanë udhëtuar në dalje nga Pika Kufitare Morinë, në datën 04.10.2022 dhe kanë udhëtuar në hyrje nga Pika Kufitare Morinë, në datën 04.10.2022.
- Shkresa nr. *** prot., datë 27.02.2023, lëshuar nga Ministria e Brendshme, ku vërtetohet se, shtetasit Lorenc Shehu, Sofie Shehu, Venera Shehu dhe Aleks Shehu, kanë udhëtuar në hyrje nga Rinasi, nëpërmjet kompanisë WIZZAIR - Milano, në datë 23.02.2023.
- Shkresa nr. *** prot., datë 27.02.2023, lëshuar nga Ministria e Brendshme, ku vërtetohet se, shtetësia Sonja Shehu ka udhëtuar në dalje nga Rinasi në datat: 07.10.2021, 24.10.2021, 14.01.2022, 31.03.2022, 11.05.2022, 21.06.2022, 06.10.2022, 31.11.2022 dhe 09.01.2023 si dhe ka udhëtuar në hyrje nga Rinasi në datat: 18.11.2021, 25.12.2021, 04.02.2022, 06.05.2022, 16.06.2022, 01.08.2022, 25.11.2022, 19.12.2022 dhe 23.02.2023.

49. Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti ka konfirmuar se, vlera e shpenzimeve për udhëtime, në mungesë të dokumentacionit justifikues, janë deklaruar me përfaqësi. Lidhur me udhëtimin në Itali, në shkurt 2023, subjekti ka konfirmuar sipas deklaramit duke sqaruar se paraqet komunikimin me e-mail me vajzën e dajës, datë 18.01.2023 dhe faturën e hotelit të paguar nga ana e familjes së dajës (A.Z).

B/lidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024, u administrua:

- Printim i komunikimit me postë elektronike, datë 18.01.2023, me dërgues I.Z, me objekt: Ftesë për Lorenc Shehu me familjen.
- Faturë pagese me kasë nga Hotel Re (Itali), datë 22.02.2023, për shumën 577.5 euro.
- ✓ Konfirmohet deklarimi mes deklaramit e dhëna dhe dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrie - daljeve nga R.SH, të subjektit dhe personave të lidhur gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022.
- ✓ Shpenzimet e deklaruara për udhëtime private të subjektit gjatë periudhës 01.01.2020 - 31.12.2022 rezultojnë në total rreth 1.200 euro e konvertuar rreth 138.000 lekë.

50. Trupa vlerësuese e AMP në vijim të verifikimi të subjektit të vlerësimit në lidhje me hyrje dhe dalje në territorin e R.SH, për sa i përket mjeteve me të cilët ka lëvizur, subjektit me e-mailin e datës 26.09.2024, Trupa Vlerësuese ju drejtua me pyetjet si më poshtë:

1. Me datë 11.09.2013 ne orën 11:28 keni dalë nga P.K.K Morina me mjetin me targa AA***CG dhe jeni kthyer me datë 13.09.2013 në orën 11:47 me automjetin me targe AA***CD. Nga verifikimet e kryera rezultojnë se ky automjet në datën që ju keni hyrë nga kufiri rezultojnë në pronësi të shtetasit K.F.Ç. Lidhur sa më sipër kërkohet informacion për sa i përket marrëdhënies që ju keni me këtë shtetas, gjithashtu na konfirmoni te dhënat e sistemit tims të konstatuara nga Trupa Vlerësuese.

Në kthim përgjigjen e tij me e-mailin e datës 27.09.2024 subjekti sqaron se:

- Sqarohet se me datën 11.09.2013 me bashkëshorten dhe dy fëmijët me mjetin privat me targë AA***CG, kemi shkuar për qëllim turistik në Kosovë dhe kemi ndenjur deri në datë 13.09.2013 dhe jemi kthyer po me të njëjtin mjet me targë AA***CG ne orën 11:47, nëpërmjet Pikës Kalimit Kufitar Morina .

- *Theksoj se si hyrja dhe dalja nga PKK Morina , është bërë me të njëjtin mjet me targën AA***CG por ndoshta ndonjë gabim njerëzor nga punonjësit që kanë bërë regjistrimin ka ndryshuar germën e fundit nga G në D, dhe nuk është e saktë si gjetje.
Po ashtu shtetasin K.F.Ç nën përgjegjësin time ligjore deklaroj se as e kam dëgjuar dhe as e kam njohur asnjëherë.*
 - 2. Me datë 28.10.2015 në orën 08:11 keni dalë nga P.K.K Qafë Thanë me mjetin me targa AA***FE dhe jeni kthyer me datë po me të njëjtin datë në orën 16.33 min., me të njëjtin automjet. Nga verifikimet e kryera rezulton se ky automjet në datën që ju keni hyrë nga kufiri rezulton në pronësi të shtetases V.C. Lidhur sa më sipër kërkojmë informacion për sa i përket marrëdhënies që ju keni me këtë shtetase, gjithashtu na konfirmoni të dhënat e sistemit tims të konstatuara nga Trupa Vlerësuese.
Në kthim përgjigjen e tij me e-mailin e datës 27.09.2024 subjekti sqaron se:
 - *Sqaroj se me datën 28.10.2015 në orën 08:11 kam dal nga Pika e Kalimit Kufitar Qafë Thanë me mjetin AA***FE, në pronësi të shtetases V.C. dhe jam kthyer në orën 16.33 me të njëjtin mjet. Qëllimi i daljes në drejtim të Shkupit ka qenë për arsye shëndetësore pasi mbas operacionit që kam bërë (Gjermani) në këmbë në vitin 2008 , kam bërë konsulta të vazhdueshme dhe vazhdoj ende ta ndjek me terapi dhe mjekime me specialist për shkak të ndërhyrjes së vështirë që kam bërë .
Kam udhëtuar me bashkëshortin e shtetases V.C. me mjetin AA***FE, pasi mjete ishte në pronësi të saj. Këtë Shtetase e kemi komshiu te shtëpia që kemi banuar te ish *** , Rruga *** dhe kemi njohje familjarisht prej shumë vitesh. Bashkëshorti i saj ndiqte studime për degën Juridik në Universitetin e Shkupit gjatë kësaj kohe dhe udhëtimi i tij për në Universitet në Shkup u shfrytëzua nga unë për vizitë të specializuar në qendrën Spitalore në Shkup vajtje dhe kthim brenda ditës.*
 - 3. Me datë 04.10.2022 ne orën 06:39 keni dalë nga P.K.K Morina me mjetin me targa AB***DK dhe jeni kthyer po në të njëjtën datë në orën 18:30 me të njëjtin automjet. Nga verifikimet e kryera rezulton se ky automjet në datën që ju keni hyrë nga kufiri rezulton në pronësi të shtetasit L.S.P. Lidhur sa më sipër kërkojmë informacion për sa i përket marrëdhënies që ju keni me këtë shtetas, gjithashtu na konfirmoni të dhënat e sistemit tims të konstatuara nga Trupa Vlerësuese.
Në kthim përgjigjen e tij me e-mailin e datës 27.09.2024 subjekti sqaron se:
 - *Sqaroj se me datën 04.10.2022 kam dal nga PKK Morina me mjetin AB***DK dhe jam kthyer ne orën 18:30 me po këtë mjet. Kam udhëtuar me bashkëshortin dhe vajzën Sonja Shehu pasi kam shkuar për vizite mjekësore të vajzës në spital në Prishtinë.
Me shtetasin L.S.P. kemi njohje dhe marrëdhënie familjare për më shumë se 25 vjet. Është me profesion mekanik - motorist. Për shkak të mos pasjes së mjetit tim në gjendje pune kam marrë në përdorim për këtë udhëtim, mjetin e mikut tim L.P. me targë AB***DK.*
51. Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin llojin e institucionit arsimor emrin e institucionit pagesat vjetore si dhe kohëzgjatjen e studimeve sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të vlerësimit: “Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.”

52. Shpenzime për arsimimin e fëmijëve: Vajza Sonja Shehu ka qenë studente e shkollës jopublike 'Albanet' nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, ka vazhduar gjimnazin në shkollën publike 'Sami Frashëri' dhe, aktualisht, ndjek studimet në Universitetin publik 'Otto Von Guericke Magdeburg', në Gjermani, me tarifë 130 euro/semestër shkollor dhe qira 225 euro/muaj në konviktin e shkollës. Në datën 30.08.2021, janë kaluar nga kredia 10.336 euro, në Llogari të mbyllur bankare në bankën online 'Expatrio', të cilat kanë kaluar çdo muaj në Llogarinë personale të 'Deutsche Bank'. Shuma e shpenzuar: 10.336 euro.
53. Nga anëtarja e Trupës Vlerësuese zj. Denisa Sina në seancën dëgjimore u pyet subjekti i vlerësimit z. Shehu, në lidhje me burimin financiar të shumës prej 10.336 euro, e cila është përdorur për shkollimin e vajzës së tij Sonja Shehu, e cila aktualisht ndjek studimet në një Universitet Publik në Gjermani.
Subjekti i Vlerësimit në kthim përgjigjen e tij sqaroi se: Shuma prej 10.336 euro, e cila ka kaluar në një llogari të mbyllur në bankën online “Expatrio” ka si burim financiar kredinë e marrë në BKT, në shumën 6.000.000 lekë më datë 27.01.2021.
54. Shpenzime për arsimimin e fëmijëve: Vajza Venera Shehu ka ndjekur kopshtin publik nr. 36 'Kësulëkuqja' gjatë periudhës 2011, 2013 dhe sipas vërtetimit financiar të institucionit nr. *** prot., datë 27.02.2023, janë paguar në total 11.520 lekë. Ajo ka qenë nxënëse në shkollën jopublike “****” nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Sipas vërtetimit të këtij institucioni, detyrimet totale për të dyja vajzat, janë paguar në shumën 889.776 lekë. Klasën e gjashtë në vitin shkollor 2018 - 2019, vajza e ka kryer në shkollën jo-publike “****” dhe sipas vërtetimit të këtij institucioni nr. *** prot., datë 17.02.2023, detyrimet totale janë 160.000 lekë. Gjithashtu, vajza, Venera Shehu ka qenë nxënëse e shkollës publike *** dhe, aktualisht, ndjek arsimimin në gjimnazin publik ***, prej shtatorit 2022. Shuma e shpenzuar: 11.520 lekë + 889.776 lekë + 160.000 lekë.
55. Shpenzime për arsimimin e fëmijëve: Djali Aleks Shehu ka ndjekur kopshtin publik nr. 36 '****' dhe për vitet 2017 - 2020, pagesat sipas institucionit të pasqyruara në vërtetimin nr. *** prot., datë 27.02.2023, janë 47.840 lekë. Për periudhat tetor 2019 mars 2020 dhe tetor 2020 - qershor 2021, ka frekuentuar kopshtin '****', ku, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 1.3.2023, janë shpenzuar në total 75.000 lekë. Prej vitit 2021 dhe aktualisht, djali Aleks Shehu është nxënës i shkollës jo-publike “****” dhe sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 27.02.2023, janë paguar në total 423.730 lekë. Shuma e shpenzuar: 47.840 lekë + 75.000 lekë + 423.730 lekë.
56. Bashkëlidhur deklaratës:
- Komunikimi me postë elektronike (në gjuhën angleze), datë 30.0
 - 8.2021, ku, ISI Bank konfirmon se Sonja Shehu ka bllokuar në llogari shumën prej 10.336 euro, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të Ambasadës së Republikës Federale Gjermane, për marrjen e vizës së studentit, dhe nga kjo llogari është autorizuar tërheqja si student e shumës totale prej 861 euro/muaj, për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në Gjermani.
 - Vërtetim nxënësi datë 20.04.2018, lëshuar nga Shkolla “****”, ku vërtetohet se, nxënësja Sonja Shehu ka filluar studimet në shtator 2009 dhe aktualisht ndjek studimet në klasën e IX, për vitin

shkollor 2017 - 2018, me detyrime financiare me vlerë totale 544.988 lekë, nga të cilat, shuma 120.000 lekë është detyrim i pa likuiduar.

- Vërtetim nxënësi, datë 20.04.2018, lëshuar nga Shkolla '****', ku vërtetohet se, nxënësja Venera Shehu ka filluar studimet në shtator 2013 dhe aktualisht ndjek studimet në klasën e V, për vitin shkollor 2017 - 2018, me detyrime financiare me vlerë totale 344.788 lekë, nga të cilat, shuma 80.000 lekë është detyrim i pa likuiduar.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 27.02.2023, lëshuar nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet se fëmija Venera Shehu, ka frekuentuar Kopshtin nr. 36 deri në janar 2013. B/lidhur: Analizat e veprimeve financiare për periudhën 03.10.2011 - 27.11.2013, në shumën e shlyer, me vlerë totale rreth 11.520 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 17.02.2023, lëshuar nga Shkolla '****', ku vërtetohet se, për edukimin e nxënësës Venera Shehu, për vitin shkollor 2018 - 2019, janë kryer pagesat me vlerë totale 160.000 lekë.
- Vërtetim nr. extra prot., datë 27.02.2023, lëshuar nga Bashkia Tiranë, ku vërtetohet se, fëmija, Aleks Shehu ka frekuentuar Kopshtin nr. 36, deri në janar tetor 2019. B/lidhur: Analizat e veprimeve financiare për periudhën 02.10.2017 - 24.02.2020, në shumën e shlyer me vlerë totale rreth 47.840 lekë.
- Vërtetim nr. 10 prot., datë 01.03.2023, lëshuar nga Kopshti "****", ku vërtetohet se, fëmija Aleks Shehu, ka frekuentuar kopshtin përgjatë periudhave kohore tetor 2019 - mars 2020 dhe tetor 2020 - qershor 2021, me pagesë 5.000 lekë/muaj. Pagesa totale: 75.000 lekë.
- Vërtetim pagesash nr. *** prot., datë 27.02.2023, lëshuar nga *** ShPK, ku vërtetohet se, për edukimin e nxënësit Aleks Shehu pranë shkollës "****", për periudhën 2021 - 31.01.2023, nga prindi janë kryer pagesat me vlerë totale 423.730 lekë.
- ✚ Banka Kombëtare Tregtare me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se në llogarinë në EUR në emër të Lorenc Shehu, rezulton debitimi me transfertë i shumës 1.195 euro, në datën 20.10.2021, me përshkrimin "Lorenc Shehu për *** ShPK, pagesë tarife shkollimi për Aleks Shehu (klasa e parë)".
- ✚ Banka Kombëtare Tregtare me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se në llogarinë në LEK në emër të Lorenc Shehu, rezulton debitimi me transfertë i shumës 138.730 lekë, në datën 24.03.2022, me përshkrimin "Lorenc Shehu për *** ShPK, pagesë tarife shkollimi për Aleks Shehu".
- ✚ Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 03.08.2023, konfirmon se, në emër të Sonja Shehu rezulton llogari rrjedhëse në EUR, e mbyllur në datën 07.01.2022. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi me konvertim i shumës 10.319 euro, në datën 30.08.2021 dhe debitimi me transfertë i shumës 10.336 euro, në datën 30.08.2021, me përshkrimin "kalim fondi në llogarinë e kursimit për student në Gjermani".

Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti ka konfirmuar sipas deklaramit duke sqaruar se shumata e rezultuara të palikujduara sipas dokumentacionit të paraqitur janë likuiduar deri në momentin e deklaramit duke patur parasysh se një pjesë e dokumentacionit të paraqitur është lëshuar në vitin 2018. Gjithashtu, ka konfirmuar se shuma e deklaruar si shpenzim për shkollimin e vajzës Sonja Shehu në Gjermani, përfshin pagesën për shkollim dhe përballimin e shpenzimeve për jetesë dhe banim, duke sqaruar se, përveç transaksioneve bankare sipas deklaramit si më sipër, vajza ka kryer transaksione bankare me shtetas të njohur prej saj (kryesisht studentë në të njëjtin universitet në Gjermani) si dhe ka patur mbështetje financiare cash nga ana

jonë në vazhdimësi sipas mundësive financiare, për të cilat nuk disponon dokumentacion shtesë, duke sqaruar se vlera totale e mbështetjes financiare cash, deri në mars 2023, ka qenë rreth 3.000 euro.

Bashkëlidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024, u administrua:

- Dokumentacion në gjuhën gjermane, datë 12.12.2023, lidhur me shpenzimet e studentes Sonja Shehu në Magdeburg Gjermani, me vlerë abonimi për Unionin Studentor, në shumën 248.77 euro/muaj, për periudhën 01.02.2024 - 31.08.2025.
- Dokumentacion në gjuhën gjermane, datë 15.03.2024, ku konfirmohet progresi i studimeve të Sonja Shehu në Universitetin e Magdeburg-ut, Bachelor, për periudhën 2021 - 2024.
- Dokumentacion bankar (expatrio), datë 11.03.2022, për llogarinë e studentit Sonja Shehu, me balanca 10.541 euro, në datën 18.11.2021, e cila debitohet në shumën 861 euro çdo muaj, për periudhën 01.12.2021 - 27.02.2022.
 - ✓ Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar, përgjigjen e BKT dhe përgjigjen Intesa Sanpaolo Bank.
 - ✓ Shpenzimet e kryera, për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës deri në datën 08.03.2023, rezultojnë në total rreth 13.336 euro + 1.607.866, e konvertuar rreth 3.137.000 lekë.

SHPENZIME TË TJERA

57. Shpenzime për arredimin e banesës me mandat arkëtimi nr. ***, datë 27.11.2017, për pajisje shtëpiakë me vlerë 232.000 lekë. Mandate tatimore për mobilimin e shtëpisë me nr. NIPT L52108***, në vlerën 277.000 lekë, datë 23.12.2017. Mandate me faturë tatimore me vlerë 300.000 lekë, për arredim shtëpie në dhjetor 2017. Riparime dhe lysterje shtëpie me vlerë 80.000 lekë. Të gjitha këto shpenzime, të mbuluara nga kredia në BKT. Shuma totale e shpenzuar: 612.000 lekë.

✚ Banka Kombëtare Tregtare me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se, në llogari të Lorenc Shehu, rezulton disbursimi i kredisë në shumën 1.000.000 lekë, në datën 22.11.2017.

Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti ka sqaruar se vlera totale është deklaruar si gabim material duke konfirmuar shpenzimet sipas deklarimit për arredimin e apartamentit me sip 102.82 m², me vlerë totale rreth 900.000 lekë, me burim financiar nga kredia e disbursuar në BKT, për të cilat nuk disponon dokumentacion justifikues, pasi deklarimi është kryer bazuar në formularin e interesave privatë për procesin vetting të vitit 2018, moment në të cilin ka disponuar edhe kopje të mandateve të arkëtimit të sipërcituara, të cilat për shkak të kohës së kaluar nuk i disponon aktualisht.

Kontratë kredie konsumatore datë 20.11.2017, me kredimarrës Lorenc Shehu dhe kredidhënës BKT, për disbursimin e shumës 1.000.000 lekë për rregullim shtëpie, me afat shlyerje 60 muaj. B/lidhur praktikës: Plan pagesa me afat 22.11.2017 - 22.11.2022.

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se në v. 2017, subjekti ka kryer shpenzime për arredimin e apartamentit me sip. 102.82 m², me vlerë rreth 900.000 lekë, me burim financiar nga kredia e disbursuar në BKT, në shumën 1.000.000 lekë, datë 20.11.2017.

Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me shpenzimet për arredimin e apartamentit me sip. 102.82 m², në shumën rreth 900.000 lekë, në v. 2017 dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me burimin financiar të përdorur.

58. TË DHËNA KONFIDENCIALE

1. Me vendimin nr. ***, datë 04.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 15.11.2011, konfirmo vendimit të Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 12.07.2012, u dëmshpërbleva nga kompania e sigurimeve pas pësimit të aksidentit, në shumën 7.757.530 lekë. Ekzekutimi u krye me përmbarim, në datë 13.08.2012, sipas faturës bankare dhe vërtetimit nga shoqëria përmbarimore *** ShPK. Vërtetim i datës 13.4.2018 dhe fatura bankare. Trajtuar më sipër.
2. Përfituar dhe derdhur në ProCredit Bank, siguracione aksidenti për mjetin në përdorim me targë AM***EW, në shumën monetare 320.500 lekë. Vërtetim bankar datë 29.01.2008. Trajtuar më sipër.
3. Më datën 13.08.2012, kaloi parapagim për blerje apartamenti me transfertë bankare në shumën 6.400.000 lekë, në kompaninë *** ShPK, me administrator A.S. Burimi i këtyre të ardhurave: Nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 04.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 15.11.2011, konformë vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 1783, datë 12.07.2012, nga i cili mora shumën 7.757.530 lekë. (b/lidhur, dokumentacioni vërtetues) Me shumën 6.400.000 lekë që kalova nëpërmjet bankës deri në blerjen e apartamentit u lidhën tre kontrata porosie (si garanci) njëra pas tjetrës, pasi rezultoni në shitura disa herë dhe më pas për këtë, u bënë edhe revokimet e tre kontratave.
 - a. Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2012.
 - b. Revokim i kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.05.2016.
 - c. Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2013.
 - d. Revokim i kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.05.2016.
 - e. Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013.
 - f. Deklaratë noteriale heqje dorë nga kjo kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.04.2014.

59. Në këto kushte, pasi e kuptova që në momentin e kontratës së porosisë së parë, se po më mashtronte, i kërkova administratorit të “***” kthimin e shumës 6.400.000 lekë dhe kjo shumë më është kthyer pjesë - pjesë cash, pasi nuk kryente dot veprime financiare me bankë për shkak se i kishte llogaritë bankare me probleme dhe i bllokoheshin për shkak të borxheve në banka. Me kthimin e shumës totale prej 6.400.000 lekë, mbyll marrëdhënien financiare me këtë subjekt. Theksoj se, të tre kontratat e garancisë që u lidhën, me kthimin e lekëve u revokuan dhe nuk posedoj asnjë prej tyre. Këto revokime janë bërë me vonesë dhe me prokurë të posaçme pasi administratori i kësaj kompanie kishte probleme financiare, i pabesueshëm për blerësit, në vijim u arrestua dhe si rezultat i shumë denoncimeve ndaj tij, u dënua me masën e sigurisë “arrest me burg”, ka bërë mbi 7 vite burg dhe aktualisht ndodhet me masë “arrest me burg”.

60. Bashkëlidhur deklaratës:

- Mandat pagesë nga Emporiki Bank, datë 13.08.2012, për transferimin e fondeve në vlerën 6.400.000 lekë nga Llogaria e Lorenc Shehu në Llogari të A. Sh. me përshkrimin “kalim parapagimi për blerje apartamenti”.
- Kontratë për prenotim dhe shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2012, me blerës Lorenc Shehu dhe shitës (sipërmarrës - investitor) ***ShPK, ku porositësi i porosit ndërtuesit: Lokalin nr.***, në katin e parë teknik, me sipërfaqe të përgjithshme 83 m² dhe 22 m² sipërfaqe e ambienteve ndihmëse. Çmimi për apartamentin e porositur është 7.000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. B/lidhur: Praktika.
- Revokim kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.05.2016, me porositës Lorenc Shehu, Sipërmarrës dhe Investitor *** ShPK, ku palët deklarojnë se kanë lidhur kontratën e prenotim dhe shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2012, të cilën realisht e kanë revokuar menjëherë pas lidhjes duke u kthyer në gjendjen e mëparshme (porositësi i është kthyer shuma monetare dhe sipërmarrësi ka marrë objektin e porosisë) duke formalizuar revokimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve, sot nëpërmjet këtij akti noterial.
- Kontratë për prenotim dhe shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2013, me porositës Lorenc Shehu, sipërmarrës dhe investitor ***ShPK, ku porositësi i porosit ndërtuesit: Lokalin nr. ***, në katin e parë, me sipërfaqe të përgjithshme 101.6 m², nga të cilat, sipërfaqe dyqani 90.6 m², sipërfaqe të përbashkëta 1 m² dhe sipërfaqe ndihmëse 10 m². Çmimi për ambientet e porositura është 10.000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. B/lidhur: Praktika.
- Revokim kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.05.2016, me porositës Lorenc Shehu, Sipërmarrës dhe Investitor “****” ShPK, ku palët deklarojnë se kanë lidhur kontratën e prenotim dhe shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2013, të cilën realisht e kanë revokuar menjëherë pas lidhjes duke u kthyer në gjendjen e mëparshme (porositësi i është kthyer shuma monetare dhe sipërmarrësi ka marrë objektin e porosisë) duke formalizuar revokimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve, sot nëpërmjet këtij akti noterial.
- Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013, me porositës Lorenc Shehu, sipërmarrës ***ShPK, për ndërtimin e ambientit të shërbimit nr. *** (lokali nr. **), me sipërfaqe ndërtimi 95.48 m², nga të cilat, 79.6 m² sipërfaqe e shfrytëzuar, 1.4 m² sipërfaqe e përbashkët dhe 14.48 m² sipërfaqe ndihmëse. Çmimi për apartamentin e porositur është 12.000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. B/lidhur: Praktika.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.01.2014, me deklarues Lorenc Shehu, i cili deklaron se ka prenotuar tek shoqëria ***ShPK, me administrator shtetasin A.S., sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013, një ambient shërbimi me nr. *** (lokali nr. **) me sipërfaqe totale 95.48 m², nga të cilat, 79.6 m² sipërfaqe banimi, 1.4 m² sipërfaqe e përbashkët dhe 14.48 m² sipërfaqe ndihmëse, dhe nga kjo kontratë heq dorë duke qenë dakord që të kalojë në emër të vëllait Mentor Shehu.

✚ Banka Amerikane e Investimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se në llogarinë Lorenc Shehu, rezulton kreditimi me transfertë i shumës 7.305.105 lekë, në datë 13.08.2012, me përshkrimin “kalim nga ****” ShPK, për ekzekutim vendimi”, debitimi me

transfertë i shumës 6.400.000 lekë, në datën 13.08.2012, me përshkrimin “nga Lorenc Shehu tek A.S., parapagim për blerje apartamenti”, si dhe tërheqja cash e shumës totale 900.000 lekë, në datën 15.08.2012.

- Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti ka konfirmuar se me burim financiar nga ekzekutimi i vendimit, në datën 13.08.2012, i ka transferuar shtetasit A.S., si ortak dhe administrator firmës së ndërtimit ***ShPK, shumën 6.400.000 lekë për blerje apartamenti me dakortësim verbal paraprak, duke qenë se shoqëria kishte nisur procedurat për marrjen e lejes së ndërtimit të kompleksit “****” në Astir. Në vijim, ka konfirmuar se duke kuptuar se ishte mashtruar dhe blerja e apartamentit nuk do të finalizohet (pasi as sot ky kompleks pallatesh nuk është ndërtuar), si dhe duke patur parasysh faktin se nuk kishte asnjë dokumentacion vërtetues por porositjen e një apartamenti në shumën e paguar prej 6.400.000 lekë, për të siguruar investimin e kryer dhe në pamundësi për të marrë nga pala investuese një kontratë porosie, kanë përpiluar kontratat sipas deklarami të cilat sqarohen në mënyrë kronologjike në dokumentacionin të cilin po e paraqes. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar se pavarësisht kontratave të deklaruara si më sipër, shtetasit A.S, dhe shoqërisë ***ShPK nuk i ka paguar, në asnjë rast, asnjë shumë monetare përveç shumës 6.400.000 lekë sipas transaksioni bankar dhe aktualisht nuk ka asnjë interes pasuror personal me shtetasin A.S., dhe shoqërinë ***ShPK, pasi shuma 6.400.000 leke i është kthyer pjesë -pjesë deri në datë 15.01.2014. Gjithashtu, konfirmoi se, kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013 nuk është revokuar si kontratat e tjera por është përpiluar deklarata noteriale për heqje dorë nga kjo kontratë nr. *** rep., në. *** kol., datë 15.04.2014, për të mbrojtur interesat pasurore të familjarëve të tij (babait dhe vëllait), të cilët kanë porositur apartamente në këtë shoqëri duke u mashtruar nga shtetasi A.S., duke sqaruar se nuk ka asnjë përfitim apo interes personal nga kjo marrëdhënie e familjarëve të tij me këtë shtetas dhe shoqërinë ***ShPK, duke deklaruar se kjo situatë sqarohet në mënyrë kronologjike në dokumentacionin të cilin po e paraqet. Subjekti sqaroi se, në një pjesë të dokumentacionit të paraqitur, sipërfaqet dhe numrat e pasurive të paluajtshme nuk përputhen në mënyrë të plotë duke qenë se janë lidhur në kushtet e mashtrimit dhe nxitimit për shkak të rrethanave të momentit, duke konfirmuar sipas sqarimeve të dhëna. Gjithashtu, subjekti sqaroi se, pavarësisht citimeve në disa pjesë të kontratave si më sipër, pasuritë e paluajtshme, objekt i këtyre kontratave kanë qenë njësi shërbimi dhe evidentimi si apartamente banimi ka qenë gabim material në përpilimin e këtyre dokumenteve.

- B/lidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024, u administrua:

Deklaratë datë 12.03.2024, nga shoqëria *** ShPK, me administrator shtetasin A.S, i cili deklaron se sipas transaksionit bankar në Emporiki Bank, në datën 13.08.2012, i ka marrë shtetasit Lorenc Shehu shumën 6.400.000 lekë, si parapagim për blerje apartamenti në kompleksin '****' që do të ndërtonte duke qenë në proces për marrjen e lejes së ndërtimit. Për shumën e marrë, si garanci deri në lidhjen e kontratës, deklaron se i ka lënë një Njësi (Lokali nr. ***, tek ish godina e Astir-it), sipas vlerës që ajo kishte sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2012, por për shkak të problemeve financiare që kishte, këtë njësi (edhe pse e kishte lënë si garanci) e ka shitur sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.09.2012 (pa dijeninë e shtetasit Lorenc Shehu) dhe, në këto rrethana, deklaron se i është kërkuar nga shtetasi Lorenc Shehu prishja e marrëveshjes për blerje apartamenti tek shoqëria *** si dhe lënia si garanci e një pasurie pa probleme ligjore deri në kthimin total të shumës monetare. Në vijim, deklaron se, u dakortësua që deri në kthimin total të lekëve, të lihej garanci

Njësia e shërbimit (Lokali ***tek ish godina e Astir-it) sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2013, sipas vlerës që kishte kjo pasuri. Pas verifikimeve të mëvonshme, rezultoi se, kjo pasuri e paluajtshme ishte shitur sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.05.2013, dhe në këto rrethana, si garanci për shumën monetare të marrë deri në kthimin e tyre, deklaroi se, ka lënë si garanci një tjetër Njësi shërbimi, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013, sipas vlerës që kjo njësi kishte.

Gjithashtu, deklaroi se, për arsye të mbylljes së Llogarive bankare, si pasojë e kredive në shuma të konsiderueshme, kryesisht pranë NBG Bank, shumën monetare prej 6.400.000 lekë e ka kthyer në favor të shtetasit Lorenc Shehu, pjesë-pjesë, Cash, për periudhën prill 2013 - 15.01.2014 dhe në vijim i ka kërkuar shtetasit Lorenc Shehu heqjen dorë nga prona e lënë si garanci me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.08.2013. Në vijim, saktëson se, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.01.2014, duke qenë në kushtet që pasuria e paluajtshme ishte e vetmja pronë e lirë dhe të gjitha pronat e tjera ishin të bllokuara nga bankat dhe organet e përmbarimit, u kërkuar që kjo pasuri e paluajtshme të kalonte si garanci te M. Sh. (vëllai i shtetasit Lorenc Shehu), pasi babai i tyre G. Sh. dhe shtetasi M. Sh. kishin prenotuar apartamente në kompleksin '***', pranë shoqërisë ***ShPK dhe kjo Njësi shërbimi i kaloi si garanci shtetasit M. Sh., sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.01.2014, duke deklaruar se, kur të dorëzoheshin apartamentet sipas kontratave noteriale, këta shtetas do të lironin dhe kthenin pronën e lënë si garanci sipas kësaj kontrate por që për shkak të problemeve financiare dhe ligjore, duke qenë se kompleksi '***' akoma nuk është ndërtuar, marrëdhënia financiare me shtetasit M. Sh. dhe G. Sh. nuk është mbyllur ende sipas kontratave të lidhura.

Gjithashtu, deklaroi se, për shkak të problematikave financiare që kishte shoqëria *** ShPK, u urdhërua bllokimi i të gjitha pronave të shoqërisë dhe njëkohësisht u përball me disa kallëzime penale për falsifikim dhe mashtrim dhe në vijim u dënua nga Gjykata, me masën 'Arrest me burg', duke u larguar nga Shqipëria në prill 2014 e duke u kthyer për vuajtjen e dënimit në datën 21.12.2016 (dënim i vuajtur deri në datën 03.10.2023). Në këto kushte, saktëson se kishte lënë prokurë të posaçme për kryerjen e veprimeve ligjore në mungesë të tij, duke deklaruar se kontratat që kishte lidhur me shtetasin Lorenc Shehu të cilat kishin vlerë formale dhe jo ligjore apo financiare, pasi pronat u përkisnin personave të tjerë, dhe duke mos patur asnjë detyrim apo marrëdhënie financiare të ndërsjellë, të cilat nuk ishin revokuar për shkak të problemeve të tij ligjore, në datën 09.05.2016, revokohen sipas akteve, përkatësisht me nr. *** rep., nr. *** kol., (për kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.07.2013) dhe me nr. *** rep., nr. *** kol., (për kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.08.2012).

Gjithashtu, deklaroi se, pavarësisht vlerave monetare si çmim (për shkak të vlerave që kishin pasuritë e paluajtshme Njësi), të cituara në kontratat e lidhura si garanci me shtetasin Lorenc Shehu, këtij shtetasi, i ka marrë vetëm shumën 6.400.000 lekë, sipas transaksionit bankar datë 13.08.2012 dhe këtë shumë monetare ja ka kthyer pjesë - pjesë cash, deri në datën 15.01.2014, duke saktësuar se, pas kësaj date, me shtetasin Lorenc Shehu nuk ka kryer asnjë transaksion monetar dhe nuk ka asnjë marrëdhënie apo detyrim financiar apo detyrim kontraktual për shitblerje pasurie.

- Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.09.2012, me porositet M.P. dhe sipërmarrës shoqëria *** ShPK, për pasurinë e paluajtshme (Lokali nr. ***), me sipërfaqe 72 m² dhe sipërfaqe ndihmëse 16 m². B/lidhur praktikës: Planimetria.

- Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.05.2013, me porositës H.D, dhe sipërmarrës shoqëria '***' ShPK, për pasuritë e paluajtshme (Lokali nr. ***; Lokali nr. ***; Lokali nr. ***; Lokali nr. ***). B/lidhur praktikës: Planimetria.
- Kontratë për prenotim dhe shit-blerje pasurie të paluajtshme datë 21.11.2012, me blerës M. Sh, dhe shitës shoqëria '***' ShPK, për porositjen e apartamentit nr. ***, me sipërfaqe 63.87 m², me vlerë 28.742 euro, nga të cilat, shuma 14.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe diferenca prej 14.742 euro do të likuidohet sipas marrëveshjes mes palëve. B/lidhur: Praktika.
- Kontratë për prenotim dhe shit-blerje pasurie të paluajtshme dalë 21.11.2012, me blerës G. Sh, dhe shitës shoqëria "****" ShPK, për porositjen e apartamentit nr. ***, me sipërfaqe 104.2 m², me vlerë 46.890 euro, nga të cilat, shuma 20.000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe diferenca prej 26.890 euro do të likuidohet sipas marrëveshjes mes palëve. B/lidhur: Praktika.
- Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.01.2014, me porositës M. Sh. dhe sipërmarrës shoqëria '***' ShPK, për ndërtimin dhe vënien në dispozicion të ambientit të shërbimit me nr. ***, Lokali nr. ***, me sipërfaqe totale 95.48 m², nga të cilat, sipërfaqe banimi 79.6 m², sipërfaqe e përbashkët 1.4 m², sipërfaqe ndihmëse 14.48 m². Çmimi për ambientin e porositur është 114.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. B/lidhur: Praktika.
- Vendim nr. ***, datë 01.12.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit A. Sh. për veprën penale të 'mashtrimit' dhe dënimi i tij me 20 vite burgim.
- Vendim nr. ***, datë 09.10.2017, i Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 01.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me ndryshimin: deklarimi fajtor i të pandehurit A. Sh. për veprën penale të 'mashtrimit' dhe dënimi i tij me 7 vite burgim.
- Vendim nr. *** datë 28.01.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit A. Sh., për veprën penale të 'mashtrimit' dhe dënimi i tij me 10 vite burgim.
- Vendim nr. ***, datë 09.10.2017, i Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është vendosur ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 28.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si vijon: deklarimi fajtor i të pandehurit A. Sh. për veprën penale të 'mashtrimit në kredi' dhe dënimi i tij me 2 vite burgim.
- Vendim nr. ***, datë 19.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurit A. Sh. për veprën penale të 'mashtrimit' dhe dënimi i tij me 10 vite burgim.
- Vendim nr. ***, datë 16.12.2019, i Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 19.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me ndryshimin: deklarimi fajtor i të pandehurit A. Sh. për veprën penale të 'mashtrimit' dhe dënimi i tij me 9 vite burgim.
- Vendim nr. ***, datë 24.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të pandehur shtetasin A. Sh., i akuzuar për veprën penale të mashtrimit. (dokumenti pjesshëm) .
- Vendim nr. ***, date 04.06.2020, i Gjykatës se Apelit Vlorë, ku është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. *** datë 17.02.2020, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me ndryshimin: në bashkim të dënimeve, dënimin e të dënuarit A. Sh. me 9 vite burgim.
- ✓ Konstatohet se: Në dt. 13.08.2012, subjekti ka transferuar shumën 6.400.000 lekë, në favor të shtetasit ***, administrator i shoqërisë *** ShPK, për porosi të një apartamenti banimi (që do

ndërtohej në kompleksin "****"), për të cilin, në pamundësi për të hartuar kontratën përkatëse, si garanci, ka lidhur kontratën e porosisë nr. ***, dt. 15.08.2012 (revokuar) dhe kontratën e porosisë nr. ***, dt. 25.07.2013 (revokuar). Për shkak se pasurisë e paluajtshme, objekt i kontratave të porosisë, janë gjendur të tjetërsuara në favor të shtetasve të tjerë nga shoqëria, në dt. 22.08.2013, subjekti ka lidhur kontratën e porosisë nr.***, për pasurinë e paluajtshme, nga e cila ka hequr dorë me deklaratën noteriale nr. *** kol., datë 15.01.2014, pas kthimit total të shumës 6.400.000 lekë (kthyer pjesë-pjesë) nga shtetasi A. Sh. Ky shtetas është dënuar për mashtrim në shuma të mëdha dhe për shtetas të ndryshëm.

- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me transaksionet bankare dhe kontraktuale me shtetasin A. Sh. dhe shoqërinë ***ShPK.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – SOFIE SHEHU

DEKLARI I PASURIVE:

61. 5. **Llogari bankare në Raiffeisen Bank, me nr. 001053***-AL, me balancë në datën 27.02.2023. Vlera: 132 lekë.** Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga. Zotëron 100%.

- Statement nga Raiffeisen Bank, printuar në datën 27.02.2023, për llogarinë e pagës në emër të Sofie Shehu, me balancë 132 lekë. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga për periudhën 31.01.2018 - 07.02.2023.

✚ Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon se, në emër të Sofie Shehu rezulton llogari page me balancë 132 lekë, në datën 27.02.2023 dhe balancë 54.493 lekë, në datën 08.03.2023. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga dhe shpërblimet për periudhën 02.02.2018 - 08.03.2023.

- ✓ Konstatohet: Llogaria në Raiffeisen Bank është krijuar gjatë periudhës 2018 - 2023. RFZ Bank konfirmon llogarinë e pagës së Sofie Shehu. Gjendja në dt. 08.03.2023 ka qenë 54.493 lekë.

62. **DEKLARIMI I TË ARDHURAVE:**

- Të ardhura të llogaritura përafërsisht nga paga neto si juriste në shoqërinë "****" ShPK, për periudhën tetor 2002 - shtator 2003. Shuma: 120.000 lekë.
- Të ardhura nga pagat neto si jurist në shoqërinë "****" ShPK, për periudhën tetor 2003 - mars 2006, sipas vërtetimit të shoqërisë. Shuma: 1.494.000 lekë.
- Të ardhura nga pagat neto si juriste në shoqërinë "****" ShPK, për periudhën prill 2006 - shtator 2006, sipas vërtetimit të shoqërisë. Shuma: 55.560 lekë.
- Të ardhura nga paga neto si juriste në AKKP, për periudhat 01.10.2006 - 01.03.2008, 01.04.2008 - 31.05.2008; 01.06.2009 - 31.12.2009, sipas vërtetimit nga sigurimet. Shuma: 739.040 lekë.
- Të ardhura nga rroga si specialiste juriste në Komisariatit e Policisë Rrugore, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, për periudhën janar 2018 - prill 2018. Shuma: 78.114 lekë.
- Të ardhura si specialiste juriste në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën prill 2018 - qershor 2018. Shuma: 118.283 lekë.
- Të ardhura si specialiste juriste në Drejtorinë e Policisë Tiranë, për periudhën korrik 2018 - qershor 2019. Shuma: 542.132 lekë.

- Të ardhura si specialiste juriste në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, Ministria e Brendshme, për korrik 2019. Shuma: 78.144 lekë.
- Të ardhura si specialiste juriste në Drejtorinë e Policisë Tiranë, për periudhën gusht 2019 - shkurt 2021. Shuma: 817.304 lekë.
- Të ardhura si specialiste juriste në Drejtorinë e Policisë Tiranë, për periudhën mars 2021 - mars 2023. Shuma: 1.328.146 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës *** ShPK, ku vërtetohet se, Sofie Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto në shumën 9.403 lekë në tetor 2002 dhe është trajtuar me raport, për periudhën nëntor 2002 - dhjetor 2002.
- Vërtetim nr. 3048 prot., datë 16.04.2018, lëshuar nga ISSH, ku vërtetohet se, Sofie Shehu ka qenë e siguar në subjektin *** ShPK, për periudhën 01.10.2002 - 30.09.2003.
- Vërtetim për pagën neto datë 11.04.2018, me punëdhënës *** ShPK, ku vërtetohet se Sofie Shaska (Shehu) ka përfituar të ardhura nga paga neto në shumën totale rreth 1.494.000 lekë, për periudhën tetor 2003 - mars 2006.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës *** ShPK, ku vërtetohet se, Sofie Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto në shumën totale rreth 55.560 lekë, për periudhën prill 2006 - gusht 2006.
- Vërtetim datë 12.04.2007, lëshuar nga *** ShPK, ku vërtetohet se, Sofie Shehu ka qenë e punësuar pranë firmës, për periudhën 01.04.2006 - 30.08.2006.
- Vërtetim për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, me punëdhënës AKK Pronave, ku vërtetohet se, Sofie Shehu ka përfituar të ardhura nga paga neto në shumën totale rreth 206.787 lekë, për periudhën shtator 2006 - mars 2007.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 16.04.2018, lëshuar nga ISSH, ku vërtetohet se, Sofie Shehu ka qenë e siguar në subjektin AKK Pronave, për periudhat 01.10.2006 - 01.03.2007, 01.04.2008 - 31.05.2008, si dhe 01.06.2009 - 31.12.2009.
- Statement nga Raiffeisen Bank, printuar në datën 13.04.2018, ku vërtetohet se, në llogarinë e Sofie Shehu janë kredituar të ardhura nga paga dhe shpërblimet: në shumën totale rreth 740.000 lekë, për periudhën 29.09.2006 - 05.01.2010; si dhe në shumën totale rreth 78.000 lekë për periudhën 02.02.2018 - 04.04.2018.
- Statement nga Raiffeisen Bank, printuar në dalën 27.02.2023, ku vërtetohej se, në llogarinë e Sofie Shehu janë kredituar të ardhurat nga paga dhe shpërblimet, në shumën totale rreth 137.017 lekë, për periudhën 03.05.2018 - 03.07.2018; në shumën totale rreth 565.567 lekë për periudhën 02.08.2018 - 02.07.2019; në shumën totale rreth 78.778 lekë, në datën 02.08.2019; në shumën totale rreth 782.265 lekë për periudhën 03.09.2019 - 02.03.2021; si dhe në shumën totale rreth 1.257.262 lekë për periudhën 07.04.2021 - 07.02.2023.
- ✚ Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon se, në llogari të Sofie Shehu rezulton kreditimi i të ardhurave nga paga dhe shpërblimet në shumën totale rreth 739.000 lekë për periudhën 27.10.2006 - 05.01.2010; në shumën totale rreth 2.980.000 lekë për periudhën 02.02.2018 - 08.03.2023.
- ✚ ISSH me shkresën nr. nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se, për Sofie Shehu janë paguar kontributet shoqërore dhe shëndetësore për pagën bruto dhe ka përfituar të ardhura nga paga neto: nga subjekti 'Njësia Rajonale e Policisë Rrugore Tiranë për periudhën janar 2018 - qershor

2018; nga subjekti 'Drejtoria e Policisë' dhe subjekti 'Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për periudhën maj 2018 - shkurt 2021; nga subjekti "OSHEE Group" për periudhën mars 2021 - qershor 2023.

✚ ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, i kërkon informacion Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, për periudhën para vitit 2012.

✚ ISSH. Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën nr. *** prot., datë 09.08.2023, sqaron se, për periudhën 1994 - 2012, nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave të punonjësve të siguruar në subjekte shtetërore, juridik, fizik, nuk mund të konfirmohet periudha kontributeve apo paga mbi të cilën janë siguruar, n.q.s. nuk jepen emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës për shtetasit për të cilët kërkohen të dhëna.

63. Në proces-verbalin e datës 27.03.2024, subjekti ka konfirmuar të ardhurat e b/shortes nga OSHEE për periudhën mars 2021 - mars 2023, duke sqaruar se deklarimi si të ardhura nga D. P. Policisë Tiranë është gabim material.

Të ardhurat e bashkëshortes nga paga, raportet dhe pagesat, për periudhën tetor 2002 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 5.485.000 lekë.

64. DETYRIME FINANCIARE

Kredi në BKT, si bashkë kredimarrëse me b/shortin, në shumën e disbursuar 6.000.000 lekë, me datë fillimi 27.01.2021, me afat 120 muaj dhe kolateral apartamentin me adresë: Rruga '***', Pallati ***, Hyrja ***, Apartamenti ***, Kodi Postar 1016, Njësia nr. ***, Tiranë, sipas kontratës së hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.01.2021. Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.01.2021. Mbyllja e dy kredive në një kredi të vetme, nga të cilat njëra në ABI Bank (e marrë nga b/shorti në v. 2014 nëpërmjet NBG Bank) ndërsa tjetra në BKT (e marrë në v. 2018).

1. Kredi bankare në BKT, për rregullim dhe arredim të shtëpisë ku banoj, disbursuar në datën 22.11.2017, në shumën 1.000.000 lekë, me afat 5 vite, me këst 20.299 lekë/muaj sipas plan kontratës fillestare (b/lidhur).
2. Kredi bankare në NBG Bank, disbursuar në shumën 20.000 euro, në datën 20.01.2014, me afat 20 vite, me këst 150.69 euro/muaj. Gjendje në datën 16.04.2018, shuma 17.737 euro, sipas vërtetimit bankar. Sqaroj se këtë kredi e ka marrë b/shorti në emër të motrës sime M.SH., por këstet dhe të gjitha detyrimet bankare paguhen dhe mbulohen nga ana e tij. Nga kjo kredi është likuiduar shuma 12.000 euro ndaj shtetasit L.B., në shkurt 2014, dhe pjesën tjetër prej 8.000 euro ja ka akoma hua për pamundësi likuidimi, vërtetuar sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2018, nga shtetasi L.B.. Shuma e detyrimit që ka mbetur pa shlyer për dy kreditë është në vlerën 2.006.931 lekë. Shuma e detyrimit që ka mbetur pa shlyer për shkollimin e vajzës është në vlerën 1.103.608 lekë. Qëllimi: Shlyerje kredie si dhe ndjekje studimesh për shkollimin e fëmijëve dhe blerje makine. Shuma totale e detyrimit financiar: 3.110.539 lekë. Trajtuar më sipër.

DEKLARIMI I VAJZËS - SONJA SHEHU

DEKLARIMI I PASURIVE

65. **6. Llogari bankare në Raiffeisen Bank, me nr. 001162***, me balancë në datën 27.02.2023. Vlera: 55.99 euro.** Burimi i krijimit: Të ardhura nga familja. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

➤ Statement nga Raiffeisen Bank, printuar në datën 28.02.2023, për llogarinë rrjedhëse në emër të Sonja Shehu, me balancë 53.99 euro.

✚ Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023, konfirmon se, në emër të Sonja Shehu rezulton llogari rrjedhëse, hapur në datën 23.06.2021, me balancë 53.99 euro, në datën 27.02.2023 dhe me balancë 47.93 euro, në datën 08.03.2023.

✓ Konstatohet: Llogaria në Raiffeisen Bank është krijuar gjatë periudhës 2021 - 2023.

✓ RFZ Bank konfirmon llogarinë e vajzës. Gjendja rezulton 47 Euro në dt. 08.03.2023.

66. **7. Llogari bankare në Deutsche Bank (në Magdeburg), me nr. 14870***me balancë në datën 27.02.2023. Vlera: 1.082 euro.** Burimi i krijimit: Të ardhura nga prindërit: në datën 30.08.2021 janë kaluar 10.336 euro në llogari të mbyllur në bankën online 'Expatrio', nga të cilat kanë kaluar çdo muaj në llogarinë personale në Deutsche Bank. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

➤ Statement nga Deutsche Bank, printuar në datën 27.02.2023, për llogarinë në emër të Sonja Shehu, me balancë 1.082 euro.

✚ Intesa Sanpaolo Bank me shkresën nr. *** prot, datë 03.08.2023, konfirmon se në emër të Sonja Shehu rezulton llogari rrjedhëse në lek, e mbyllur në datën 07.01.2022 (firmë e autorizuar Lorenc Shehu). Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi me transfertë i shumës 1.260.000 lekë, në datën 27.08.2021 dhe debitimi me konvertim i shumës 1.260.000 lekë, në datën 30.08.2021. Gjithashtu, konfirmon se, në emër të Sonja Shehu rezulton llogari rrjedhëse në EUR, e mbyllur në datën 07.01.2022. Referuar në statement bankar, rezulton kreditimi me konvertim i shumës 10.319 euro, në datën 30.08.2021 dhe debitimi me transfertë i shumës 10.336 euro, në datën 30.08.2021, me përshkrimin "kalim fondi në llogarinë e kursimit për student në Gjermani".

67. B/lidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024 u administrua:

Statement nga Deutsche Bank, për Llogarinë në emër të Sonja Shehu, për periudhën tetor 2021 - mars 2023, ku rezulton kreditimi nga llogaria Expatrio i shumës totale rreth 10.330 euro, për periudhën dhjetor 2021 dhjetor 2022.

✓ Konstatohet: Llogaria në Deutsche Bank është krijuar gjatë periudhës 2021 - 2023.

✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Intesa Sanpaolo Bank

68. Në deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Lorenc Shehu ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile: "****", "****", Nd ***, H. ***, Njësia Administrative nr. 9, 1016 Tiranë" Bashkëlidhur deklaratës: Certifikatë personale, datë 04.03.2023, për Lorenc Shehu, i regjistruar në gjendjen civile me adresën: ***, "****", Nd ***, H. ***, Njësia nr. 9, 1016, Tiranë.

Adresa e regjistrimit në gjendjen civile, i përket pasurisë së llojit apartament, me sipërfaqe 102.82 m², trajtuar më sipër.

69. Përveç sa sipër, bashkëlidhur deklaratës: Vërtetim nga Zyra e Gjendjes Civile në Njësinë Krahës, Bashkia Memaliaj, datë 22.04.2016, ku vërtetohet se, me aktin nr. ***, datë 20.06.1992, është bërë ndryshimi i emrit të shtetasit Leorand Gëzim Shehu i dt. 27.07.1972, nga Leorand Shehu në Lorenc Shehu.

70. Në proces-verbalin e datës 25.03.2024 subjekti ka konfirmuar adresën sipas gjendjes civile e cila i përket apartamentit të deklaruar me sip. 102.82 m² si dhe ka konfirmuar ndryshimin e emrit sipas dokumentacionit të paraqitur, i kryer në vitin 1992, duke sqaruar se emri real me të cilin është thirrur vazhdimisht ka qenë Lorenc ndërkohë që regjistrimi fillestar është bërë gabimisht Leorand. Subjekti ka paraqitur dokumentacion dhe ka dhënë sqarime lidhur me ndryshimin e emrit.

71. Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe personat e lidhur kanë deklaruar deri në datë 08.03.2023, si më poshtë;

- Apartament me sipërfaqe 62.5 m², me adresë: Rruga '****', Pallati nr.***, Hyrja nr. ***, Apartamenti nr. ***, Kodi Postar 1016, Njësia nr. 9, Tiranë, blerë dhe hipotekuar në vitin 2013. Vlera: 31.500 euro. Zotëron 100%.
- Apartament me sipërfaqe 102.82 m², me adresë: Rruga “****”, Ndërtesa nr.***, Hyrja nr.***, Apartamenti nr. ***, Tiranë, blerë në v.2008, me vlerë sipas kontratë 53.768 euro.
- Llogari në BKT, me balancë në datën 27.02.2023. Vlera: 1.528 euro. Zotëron 100%.
- Llogari në BKT, me balancë në datën 27.02.2023. Vlera: 3.027 lekë. Zotëron 100%.
- Llogari bankare në emër të b/shortes Sofie Shehu, në Raiffeisen Bank, me balancë në datën 27.02.2023, 132 lekë. Zotëron 100%.
- Llogari bankare në Vlera emër të vajzës Sonja Shehu, në Raiffeisen Bank, me balancë në datën 27.02.2023. Vlera: 55.99 euro. Zotëron 100%.
- Llogari bankare në emër të vajzës Sonja Shehu, në Deutsche Bank (në Magdeburg), me balancë në datën 27.02.2023. Vlera: 1.082 euro. Zotëron 100%.
- Kredi në BKT, me bashkë kredimarrës b/shorten, në shumën e disbursuar 6.000.000 lekë, me datë fillimi 27.01.2021, me afat 120 muaj. Shuma e detyrimit të mbetur për shlyerje të dy kredive është vlera 2.006.931 lekë. Shuma e detyrimit të mbetur pa shlyer për shkollimin e vajzës, është në vlerën 1.103.608 lekë. Shuma totale e detyrimit financiar 3.110.539 lekë.
- Detyrim ndaj shtetasit L.B., për huamarrjen sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.04.2018. Shuma e detyrimit financiar: 8.000 euro.
- o Vlera e pasurisë bruto është 3.159 lekë + 87.933 Euro e konvertuar rreth 10.086.000 lekë dhe neto rreth 7.162.000 lekë. (Në këtë vlerë nuk është llogaritur kredia e disbursuar për financimin e shkollimit të vajzës. me gjendje detyrimi 1.103.608 lekë).
- o Subjekti ka detyrime financiare, nga të cilat, për kredi në shumën 2.006.931 lekë dhe i për huamarrje në shumën 8.000 euro, e konvertuar në shumën totale rreth 2.924.000 lekë. (Konvertuar me kursin e këmbimit të BSH-së datës 08.03.2023, ku 1 Euro 114.66 lekë).

72. Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Pro Credit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Credins Bank, Union Bank, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, EasyPay, Fondi Besa, Lutecredit, Kredo Financë,

konfirmojnë se, subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklarimin.

73. Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Zonat e Stimuluara; Pukë; Librazhd; Skrapar; Tepelenë; Pogradec; Lezhë; Has; Devoll; Malësi e Madhe; Tiranë Jug; Elbasan; Sarandë; Kamëz Vorë; Lushnje; Krujë; Korçë; Berat; Përmet; Tiranë Rurale 2; Tirana Rurale 1; Kukës; Peqin; Kolonjë; Tropojë; Fier; Bulqizë; Kuçovë; Kavajë; Mirditë; Shkodër; Vlorë; Gjirokastër; Durrës; Kurbin; Dibër; Gramsh; Mat; si dhe ASHK Online (përveç pasurive që konfirmohen më lart, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

Tirana Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 28.07.2023, konfirmon se në emër të Sonja Shehu rezulton llogari rrjedhëse aktive për periudhën 2003 - 2004.

Banka Amerikane e Investimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se, në emër të Aleks Shehu rezulton llogari shpërblymi për bebe, e hapur në datën 13.03.2015 dhe e mbyllur në datën 04.04.2019.

Unioni Financiar Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 03.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk kanë kryer veprime si klientë.

AK Invest, me shkresën nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk janë klientë dhe sipas përgjigjes së Money Gram Internacional (b/lidhur), nuk kanë kryer transaksione për transferua monetare.

NOA sha, me shkresën nr. *** prot., datë 10.08.2023, konfirmon se klienti Lorenc Shehu rezulton kredimarrës dhe Sofie Shehu rezulton b/kredi marrëse, për kredi me vlerë 200.000 lekë, sipas kontratës datë 26.07.2006, e likuiduar në datën 23.01.2007. B/lidhur praktikës: Kontratë huaje e siguruar me dorëzani, datë 26.07.2006, me kredimarrës Lorenc Shehu dhe Sofie Shehu, dorëzanes L.B, kredidhënës shoqëria Partneri Shqiptar Mikrokredi sha, për kredi në shumën 200.000 lekë, me afat 24 muaj.

74. Në proces-verbalin e datës 27.03.2024 subjekti ka konfirmuar kredinë e marrë në vitin 2006, për shpenzime konsumi, dhe të likuiduar në vitin 2007, me burim financiar nga të ardhurat, për të cilën nuk disponon dokumentacion justifikues. Subjekti ka sqaruar lidhur me konfirmimin e NOA sha.

OKB, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT), si person fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.

D.P. Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 02.08.2023, konfirmon se Lorenc Shehu figuron si administrator i tatimpaguesit 'Shoqata e Gazetarëve të Bujqësisë' me NIPT K6241***S, regjistruar pranë D.R.T Tiranë prej datës 30.4.2001.

75. D.R.T Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.08.2023, konfirmon se Lorenc Shehu me nr. ID: H2072***K, figuron si administrator i subjektit "Shoqata e Gazetarëve të Bujqësisë" me NIPT K6241***S, regjistruar në sistemin C@ts prej datës 14.12.2006.

D.P. Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 02.08.2023, konfirmon se G. Sh. figuron si Person Fizik me NIPT K4171***L dhe Person Fizik me NIPT K4141***J, regjistruar pranë D.T. Tiranë

prej datës 31.03.2003. Gjithashtu, konfirmon se, G. Sh. figuron si administrator i tatimpaguesit ***, me NIPT K9911***M, regjistruar pranë D.R.T Gjirokastër prej datës 31.03.2003.

76. D.R.T Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se G. Sh. me nr. ID G7071***T, figuron si administrator i OJF *** me NIPT K9911***M. Gjithashtu, konfirmon se, Gëzim Shehu (pa të dhëna identifikuese) rezulton si Person Fizik, me NIPT K4171***L dhe Person Fizik, me NIPT K4141***J, regjistruar pranë D.R.T Tiranë.

77. D.R.T Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 17.08.2023, konfirmon se, Gëzim Shehu (pa të dhëna identifikuese), figuron si Person Fizik, me NIPT K4171***L, regjistruar në sistemin C@ts prej datës 10.05.2004, me aktivitet 'punime mermeri', me status 'pasiv' prej datës 20.10.2014. Referuar sistemit tatimor, subjekti tregtar ka realizuar qarkullim me vlerë totale rreth 5.600.000 lekë, nga e cila, fitim pas tatimit me vlerë totale rreth 2.233.950 lekë, për periudhën 2005 - 2009, si dhe aktualisht ka detyrime të pa paguara me vlerë 94.072 lekë. Gjithashtu, konfirmon se, Gëzim Shehu (pa të dhëna identifikuese), figuron si Person Fizik, me NIPT K4141***J, regjistruar në sistemin C@ts prej datës 16.02.2004, i cili nuk ka dorëzuar deklarata të ardhurash dhe rezulton me status 'pasiv' prej datës 04.04.2014.

Në proces-verbalin e datës 27.03.2024, subjekti nuk ka konfirmuar sipas përgjigjeve të institucioneve tatimore duke sqaruar se as ai edhe as babai i tij nuk kanë ushtruar aktivitet privat të regjistruar pranë institucioneve tatimore.

B/lidhur proces-verbalit të datës 27.03.2024, u administrua: Vërtetim me vulë elektronike nga D.R.T Tiranë, datë 20.03.2024, ku vërtetohet se Lorenc Shehu, sipas të dhënave të sistemit informatik, nuk është i regjistruar pranë D.R.T Tiranë.

Kthim përgjigje nga Drejtoria e Hetimit Tatimor, datë 14.01.2021, ku vërtetohet se, për shtetasit Lorenc Shehu dhe G. Sh, nuk ka dhëna lidhur me aktivitet ekonomik të regjistruar.

Subjekti ka sqaruar lidhur me konfirmimin e Drejtorive Rajonale Tatimore.

Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën *** prot., datë 04.08.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruar nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë përmbledhur, rezultoi se:

- ✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 08.03.2023, është deklaruar bruto 3.159 lekë + 87.933 Euro e konvertuar rreth e konvertuar rreth 10.086.000 lekë dhe neto rreth 7.162.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e subjektit nga pagat, dietat, shpërblimet, qiratë dhe vendimet gjyqësore, për periudhën gusht 1994 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 35.490.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e bashkëshortes nga pagat dhe raportet, për periudhën tetor 2002 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 5.485.000 lekë.

Gjithashtu, janë deklaruar:

- Kredi me limit 6.000.000 lekë në BKT, nga të cilat:

- Disbursuar në shumën 2.450.000 lekë me qëllim shlyerje detyrimi kredie të shtetas M. Sh. në ABI Bank (marrë për shlyerje të pjesëshëm detyrimi, të subjektit Lorenc Shehu ndaj shtetasit L.B.). Shuma e detyrimit financiar, rreth 2.007.000 lekë.
- Disbursuar në shumën 1.260.000 lekë me qëllim financimin e shkollimit të vajzës Sonja Shehu, në Gjermani. Shuma e detyrimit financiar, rreth 1.103.608 lekë.
- Huamarrje për blerje apartamenti, në shumën 20.000 euro. Shuma e detyrimit financiar, 8.000 euro e konvertuar rreth 917.280 lekë.
- ✓ Për periudhën janar 1995 - mars 2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar së bashku me b/shorten dhe fëmijët, në total rreth 16.755492 lekë.
- ✓ Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet, në total rreth 205.000 lekë.
- ✓ Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022 janë deklaruar shpenzime për udhëtime private, personale apo të personave të lidhur, në total 1.200 euro e konvertuar rreth 138.000 lekë.
- ✓ Për periudhën deri në datën 08.03.2023, janë shpenzuar për arsimimin e fëmijëve, në total rreth 13.336 euro + 1.607.866 lekë e konvertuar rreth 3.137.000 lekë.
- ✓ Gjithashtu, subjekti ka deklaruar: shpenzime për banim me qira, për periudhën 1997 - 2007, në shumën totale rreth 750.000 lekë; shpenzime për trajtim shëndetësor pas aksidentit automobilistik në v. 2008, në shumën totale rreth 900.000 lekë (sipas vendimit gjyqësor), si dhe shpenzime për arredimin e apartamentit në v. 2017, në shumën totale rreth 900.000 lekë.

78. **Në përfundim të hetimit të kryer:** Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Lorenc Shehu:

- ✓ ***Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;***
- ✓ ***Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;***
- ✓ ***Nuk është kryer fshehje e pasurisë;***
- ✓ ***Nuk është kryer deklaram i rremë;***
- ✓ ***Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit;***

B. KONTROLI I FIGURËS

79. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

80. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
 3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
81. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Lorenc Shehu, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.
82. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:
- a) Deklaratën e Kontrollit të Figurës.
 - b) Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
83. Struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit Z. Lorenc Shehu, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim të identifikojë nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018 të ndryshuar, ka dërguar raportin përfundimtar me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2023, për subjektin e vlerësimit, në përputhje me nenin 42, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe konstaton se:
- ✓ *Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar,*
 - ✓ *Për subjektin e vlerësimit Z. Lorenc Gëzim Shehu, me detyrë Drejtor i Qendrës, Qendra e Mbyllur e të Huajve, dhe "personave të lidhur", nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar*

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës shtojca 1 subjekti ka deklaruar se:

- ✚ Gjeneralitetet
- Me Vendim të Komitetit Ekzekutiv, Këshilli Popullor Fshati Qesarat, akt. Nr. *** datë 20.06.1992 ka ndryshuar emrin nga Leorand në Lorenc Shehu, i dtl. 27.07.1972.
- Pas verifikimeve në Zyrën e Gjendjes Civile, dega e arkivës Tepelenë, nuk rezulton asnjë dokument që vërteton ndryshimin e mbiemrit nga Shehaj në Shehu.
- Se nuk është njohur nga të tjerë me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër,
- Se nuk ka pasur nënshtetësi tjetër,
- ✚ Në deklaratën për kontrollin e figurës, pjesa e 2-të, shtojca 1, subjekti deklaron të dhënat përkatëse mbi vendbanimin,

- ✚ Në pjesën 3 dhe 4, të shtojcës 1, subjekti ka deklaruar të dhëna ndër vite lidhur me arsimin, kualifikimet, specializimet apo trajnimet dhe punësimin përkatës,
- ✚ Në pjesën 5, të shtojcës 1, lidhur me të dhënat e sigurisë subjekti ka deklaruar:
 - Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj,
 - Nuk ka qenë në hetim dhe gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
 - Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
 - Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo.
 - Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
 - Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
 - Nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
 - Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
 - Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 - Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 - Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
 - Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 - Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit sipas përcaktimeve të ligjit për integritetin e personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
 - Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe të një natyre sigurie të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
 - Nuk ka kryer shkelje sigurie apo të ketë nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar.
 - Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish- shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
 - Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
 - Nuk është përdorues i lëndëve narkotike
 - Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- ✚ Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarime për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese e AMP:**

84. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektin e vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e duhura nga struktura përgjegjëse pranë AMP duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në këtë ligj.
85. Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e Vlerësimit konstatoi se:
- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 08.07.2023 konfirmon se: *Me Vendim të Komitetit Ekzekutiv, Këshilli Popullor Fshati Qesarat, ka ndryshuar emrin nga Leorand në Lorenc. Pas verifikimeve në ZGjC -dega e arkivës Tepelenë, nuk rezultojn asnjë dokument që vërteton ndryshimin e mbiemrit nga Shehaj në Shehu.*
Në lidhje me ndryshimin e emrit nga Leorand në Lorenc Shehu me e-mailin e datës 09.07.2024 subjekti u pyet se: *Në formularin tuaj të Deklarimit për Kontrollin e Figurës të Subjektit të Vlerësimit keni deklaruar se me Vendim të Komitetit Ekzekutiv të K.P. të Fshatit të Bashkuar Qesarat me aktin nr. ***, datë 20.06.1992, në moshën rreth 20 vjeçare keni bërë ndryshim të emrit nga Leorand Gëzim Shehu në Lorenc Gëzim Shehu, i dtl. 27.07.1972, por nuk specifikoni arsyet e ndryshimit të emrit. Jepni arsyen e ndryshimit të emrit tuaj nga Leorand Shehu në Lorenc Shehu.*
Në kthim përgjigjen protokolluar me tonën nr.***, datë 15.07.2024 subjekti sqaron se: *“Ndryshimi i emrit sipas dokumentacionit dhe deklaramit, është kryer për arsye se, prej lindjes, emri real me të cilin jam thirrur vazhdimisht ka qenë Lorenc (si emri i vendosur nga familja për regjistrimin tim) ndërkohë që regjistrimi fillestar është bërë gabimisht Leorand”.*
 - **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 28.07.2023 konfirmon se : *Nuk rezultojn i dënuar.*
 - **Organi ligjzbatues** me shkresën “Sekret” nr. *** prot., datë 15.08.2023 bën me dije se: *Pas verifikimeve të kryera për Z. Lorenc Gëzim Shehu nuk ka të dhëna në lidhje me cenimin e sigurisë kombëtare, apo aktivitet të kundërligjshëm.*
 - **Organi ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 11.08.2023 konfirmon se:
 - a) *Nuk ka dhëna apo indice për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.*
 - b) *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.;*
 - c) *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;*
 - d) *Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;*

- e) *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;*
- f) *Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;*
- g) *Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;*
- h) *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-S;*
- i) *Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.*
- j) *Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.*
- **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes** me shkresën “Konfidencial” nr. *** prot., datë 04.08.2023 konfirmon se: *Nuk disponon të dhëna.*
 - **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “Sekret” datë 03.08.2023 dhe shkresën “Sekret” nr. *** prot., datë 03.10.2023 si edhe me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 16.08.2023 bën me dije se:
 - o *Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm.*
 - o *Nuk ka procedime penale të referuara*
 - o *Nuk disponohen ankesa , të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.*
 - **Organi ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 27.09.2023 konfirmon se:
 - o *Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.*
 - o *Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata*
 - o *Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të K.P.P.*
 - o *Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale.*
 - o *Nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit.*
 - Nga një institucion tjetër ligj zbatues me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 11.08.2023 bën me dije se:
 - o *Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.*
 - o *Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal.*
 - o *Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të kodit të Procedurës Penale.*
 - o *Nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit.*
 - Nga një institucion tjetër ligj zbatues me shkresën “Sekret” nr. *** prot., datë 04.08.2023 konfirmon se:
 - o *Nuk rezulton raportime financiare.*
 - **Organi ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 30.05.2024 konfirmon se:
 - o *Nuk rezulton se në emër të shtetasve të mëposhtëm të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.*
 - **Organi ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 26.06.2024 konfirmon se:
 - o *Nuk rezulton se në emër të shtetasve të mëposhtëm të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.*
 - o *Ndërsa për shtetasin Lorenc Shehu janë regjistruar materiali hetimor nr.*** datë 20.04.2023, për të cilin është marrë vendimi i mos fillimit më datë 20.04.2023, dhe materiali verifikues nr.*** datë 20.05.2024, i cili është në verifikim.*
 - o *Në lidhje me materialin verifikues nr.*** datë 20.05.2024, Trupa Vlerësuese e A.M.P me shkresën e saj nr. *** datë 26.08.2024, ju drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, lidhur me përmbajtjen e këtij materiali si dhe*

ecurinë e verifikimit, dhe në kthim përgjigjen e saj me shkresën nr. *** Prot datë 17.09.2024, protokolluar me tonën me nr. *** datë 19.09.2024, është marrë vendimi i mos fillimit më datë 30.06.2024

- **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar** me shkresën “I kufizuar, nr. *** prot., datë 31.07.2023 konfirmon se :
 - o Nuk është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të vlefshme.
 - o Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
 - o AKSIK nuk disponon rekorde sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- **Avokati i Popullit** me shkresën “E paklasifikuar” nr., *** prot., datë 14.08.2023 konfirmon se:
 - o Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
 - o Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti
- **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** me shkresën “I kufizuar” nr.*** datë 24.11.2023 bën me dije se:
 - o Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i shtetit deri më 02 Korrik 1991.Në deklaratën për Kontrollin e Figurës për Vlerësimin Kalimtar, subjekti i vlerësimit z. Lorenc Shehu ka deklaruar se, me Vendim të Komitetit Ekzekutiv K.P Fshatit Bashkuar Qesarat, me akt Nr. ***, datë 20.06.1992 është bërë ndryshimi i emrit të shtetasit Leorand Gëzim Shehu, i datëlindjes 27.07.1972 nga Leorand Shehu, në Lorenc Shehu.

86. Pranë Trupës Vlerësuese, nuk janë paraqitur denoncime nga publiku ndaj subjektit të vlerësimit Lorenc Shehu, për shkelje të rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të nenin 36 pika “ë” të ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar).

87. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit z. Lorenc Shehu në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, me shkresën nr. *** prot., nr. *** regj. datë 29.05.2024 të Institutit Mjekësisë Ligjore protokolluar me tonën nr. ***, datë 31.05.2024 ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara të testimit për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

- Në mostrën e urinës marrë subjektit me kod shifror ***, mbyllur në kontejner, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (tricklike antidepresante), AMP (amfetamine), MDMA (ekstazi), BZO (benzodiazepina), MET (metamfetamina).

88. **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Lorenc Shehu:

- ✓ *Ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- ✓ *Nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

89. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
90. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
- a. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
 - b. Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
91. Subjekti i vlerësimit Z. Lorenc Shehu në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtor i Qendrës në Qendrën e Mbyllur të Huajve, në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
92. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit mbështetet në informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga DPPSH, në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ kryesisht si dhe nga burime të tjera të ligjshme për nivelin e arsimimit në përputhje me pozicionin e punës. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, është kryer në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të Ligjit nr. 12/2018 (i ndryshuar) bazuar në nenet 43 - 46 të po këtij ligji.
93. Lorenc Shehu është subjekt i vlerësimit të ligjit nr. 12/2018 dhe aktualisht mban detyrën Drejtor i Qendrës në Qendrën e Mbyllur të Huajve, në Departamentin e Kufirit dhe Migracionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, bazuar në urdhërin e emërimit, Nr. *** datë 29.06.2023 , të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit 43 të këtij ligji, ka të bëjë me vlerësimin e nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga subjekti në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.
94. Procedura për vlerësimin e aftësive profesionale kryhet bazuar në nenet 44 - 46 duke mbajtur në vëmendje aftësitë profesionale dhe ecurinë në karrierë të punonjësit duke respektuar

legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës (në këtë rast Ligji për Policinë e Shtetit, Rregullorja e Policisë dhe aktet e tjera rregullatorë e nënligjore në fuqi) si dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

Trupa Vlerësuese përdor si burime për vlerësimin e saj, fillimisht:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

- Më tej të dhënat nga institucionet përgjegjëse që konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit dhe nga vërtetime e akte të tjera administrative të emërimeve në funksione dhe dhënies së gradave respektive, ecurinë disiplinore, vendimet e formës së prerë të gjykatave që lidhen me procese disiplinore etj. Vlerësimet e punës individuale në pesë vitet e fundit. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe shqyrton edhe denoncimet nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë jo etike.

- Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:

Subjekti i vlerësimit Lorenc Shehu ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (Formularin e Vetëvlerësimit të Aftësive Profesionale), sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit Nr. 12/2018 të ndryshuar. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

95. Subjekti në kohën e depozitimit të formularit, mbante detyrën e Drejtor i Qendrës së Mbyllur të Huajve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shteti, funksion që e mban që prej datës 01.07.2023.

VLERËSIMI I NIVELIT ARSIMOR

96. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punë, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2/a e ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar. Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit, rezulton së subjekti ka përfunduar arsimin e lartë.

97. Në formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar subjekti ka deklaruar:

- ✓ Akademia e Forcave Tokësore 1990-1994 cikli 4 vjeçar Tiranë. Diplomë me nr. Regjistri ***, datë 28.02.1994.
- ✓ Akademia e Policisë cikli mësimor 1994 - 1999. Diplomë nr. regjistri ***, datë 30.08.1999.
- ✓ Universiteti “Albania University”, Postmaster në “Studime mbi Sigurinë”, Nr.***, regjistrin Nr. Matrikullimit UFSQFK***, Nr. Masterit Shkencor ***, viti studimit 2010 - 2011.
- Të dhënat janë të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit me nr. ***.
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me numër ***.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në Formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e Subjektit.

- Të dhënat e siguruara nga burimet e mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet dhe vlerësimet individuale të punës si edhe performancën e konstatuar gjatë kontrolleve dhe inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucionet e tjera mbikëqyrëse.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfunduar	Vendi	Titulli/ Diploma
Arsim i Lartë	Akademia e Forcave Tokësore "Skenderbej"	1990	1994	Tiranë	Diplomë (Specialist Këmbësor)
Arsim i Lartë	"Akademia e Policisë"	1994	1999	Tiranë	Diplomë
Postmaster në Studimet mbi Sigurinë	"Albania University"	2010	2011	Tiranë	Diplomë

Në kuptim të ligjit Nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti rezulton se subjekti, përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

❖ Arsyetimi ligjor i Trupës Vlerësuese

98. Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit dhe në ligjin në fuqi Nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit, rezulton se subjekti ka kryer edhe trajnime dhe specializime dhe për këtë ka marrë edhe certifikatat përkatëse. Ai u ka kushtuar rëndësi trajnimeve që kanë të bëjnë me objektin e tij të punës si dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe Workshop-e të ndryshëm.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ai ka kryer trajnimet/specializimet si më poshtë:

1.	1997	Kurs policor dyjavor	Certifikatë
2.	2000	Kurs për njohjen dhe përdorimin e kompjuterit	Certifikatë
3.	2000	Kurs tre javor	
4.	2002	Kursin e menaxhimi, planifikimi dhe mbikëqyrjes ICITAP	Certifikatë
5.	2003	Kurs një mujor në Egjipt	Certifikatë
6.	2004	Kurs për policinë dhe median	Certifikatë
7.	2007	Veprimtaria e policisë për sigurimin e rendit në aktivitetet masive	Certifikatë
8.	2007	Veprimtaria e policisë në rastet e emergjencave civile	Certifikatë

9.	2007	Bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe entet pronar të rrugëve	Certifikatë
10.	2008	Veprimet policore në aktivitetet masive demonstratat, aktivitetet sportive	Certifikatë
11.	2008	Roli i policisë në zbatimin e legjislacionin kundër dhunës në familje	
12.	2009	Përpunimi dhe plotësimi i statistikave të policisë së shtetit	Certifikatë
13.	2009	Bashkëpunimi institucional midis strukturave të policisë, ushtrisë dhe pushtetit vendor	Certifikatë
14.	2009	Trajno trajnerët mbi detyrat që do të kryejnë punonjësit gjatë periudhës zgjedhore 2009	Certifikatë
15.	2010	Kurs për forcat e ndërhyrjes	Certifikatë

Gjithashtu gjatë karrierës rezulton se subjekti ka marrë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave e konkretisht:

1.	2013	Certifikatë të Karrierës
2.	2017	Certifikatë së Karrierës
3.	2019	Dhënie medalje “Për trimëri”

❖ **VLERËSIMET E PUNËS:**

99. Në dosjen personale të subjektit, për periudhën 2018 - 2023 rezulton së janë të administruara 4 (katër) vlerësime të aftësive individuale të punës një mungon, në të cilat është vlerësuar si vijon:

- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 27 pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 nuk administrohet
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 28 pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 28 pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 96 pikë (shumë mirë)

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të subjektit, Trupa Vlerësuese vlerëson se subjekti ka përbushur detyrat profesionale respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

❖ **Konkluzion i Trupës Vlerësuese:**

100. Bazuar në vlerësimet e mësipërme të punës Trupa Vlerësuese arrin në konkluzion se subjekti i vlerësimit ka përbushur detyrat funksionale, respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

Nga verifikimi në dosjen personale si dhe sistemin RMIS, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit, nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore. Për sa analizuam rezulton se deklarimi i subjekti është i saktë.

❖ **ECURIA NË KARRIERË:**

101. Subjekti Lorenc Gëzim Shehu ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 28 vitesh e 11 muaj. Nga verifikimi në dosjen personale rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Lorenc Gëzim Shehu, ka ecurinë në karriere si vijon:

- ✓ 05.07.2018 deri më 01.10.2019 Komandant Reparti Special RENEA,
- ✓ 01.10.2019 deri më 05.07.2021 Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës,
- ✓ 06.07.2021 deri më 18.10.2021 Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë,
- ✓ 19.10.2021 deri më 30.06.2024 Drejtor i Qendrës në Qendrën e Mbyllur të Huajve,
- ✓ 01.07.2024 e në vazhdim Zëvendësdrejtor për Sigurinë Publike në D.V.P. Elbasan.

102. **ECURIA NË GRADË:**

- a) Me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik, Nr. ***, datë 21.09.2006 “Për caktimin e gradës policore të një punonjësi policie sipas funksionit organik që kryen” N/Komisar Lorenc Shehu me detyrë Komandant i Repartit Policisë Rendit në Komisaratin e Policisë Mirditë për arsye të mospërputhjes së gradës me funksionin organik, ti caktohet grada korresponduese e funksionit “Inspektor”.
- b) Me urdhër të Drejtorit të Policisë së Qarkut Lezhë nr. ***, datë 20.06.2008 “Për dhënien e Gradës Policore një punonjësi policie” Inspektor Lorenc Shehu me detyrë Shef Sektori në Sektorin e Rendit dhe Sigurisë Publike në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Lezhë i jepet grada policore “K/Komisar”.
- c) Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. ***, datë 24.05.2022 “Për dhënien e Gradës Policore një punonjësi policie” K/Komisar Lorenc Shehu, me detyrë Drejtor i Qendrës, në Qendrën e Mbyllur të Huajve, i shpallur fitues në konkurrim dhe përfunduar arsimin për fitimin e gradës “Drejtues” i jepet grada policore “Drejtues”.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE:

103. Në zbatim të ligjit ***, datë 20.07.2000 “Për gradat në Policinë e Shtetit” punonjësit e policisë që kryejnë detyrën në funksionet organike, me gradë më të lartë se grada respektive e funksionit organik e përcaktuar në V.K.M. nr. 64, datë 02.02.2001 “Për inkuadrimin e gradave ushtarake në gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve që do të ushtrohen sipas tyre” Me urdhër të Ministrit të Rendit Publik Nr. ***, datë 21.09.2006, “Për caktimin e gradës policore të një punonjësi policie sipas funksionit organik që kryen”, N/Komisar Lorenc Shehu me detyrë Komandant i Repartit Policisë Rendit në Komisaratin e Policisë Mirditë, për arsye të mospërputhjes së gradës me funksionin organik, ti caktohet grada korresponduese e funksionit “Inspektor”.

✓ **Trupa Vlerësuese konstaton se, kalimi nga grada N/Komisar në “Inspektor” për shkak të mospërputhjes së gradës me funksionin organik është dhënë në përputhje të plotë të ligjit.**

104. Në mbështetje të Ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, si edhe në Rregulloren e Policisë së Shtetit, e ndryshuar, si edhe në disa Urdhëra të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për fitimin e gradës policore “Drejtues i Parë” dhe “Drejtues” si edhe në Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. ***, datë 05.05.2022 “Për miratimin e listës emërore për gradë të aplikantëve fitues të gradës policore

“Drejtues” K/Komisar Lorenc Shehu, me detyrë Drejtor i Qendrës, në Qendrën e Mbyllur të Huajve, i shpallur fitues në konkurrim dhe përfunduar arsimin për fitimin e gradës “Drejtues”, i jepet grada policore “Drejtues”.

105. **Trupa Vlerësuese konstaton se**, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të Z. Lorenc Gëzim Shehu arrijmë në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

106. **Në përfundim të hetimit të kryer**, Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Lorenc Shehu:

- ✓ *Është i përshatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
- ✓ *Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;*
- ✓ *Ka vlerësime pozitive pune.*

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e AMP, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike datë 09.10.2024, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Lorenc Shehu në përputhje me nenin 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- **Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,**
- **Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,**
- **Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.**

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit e AMP, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar:

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, **Z. Lorenc Gezim Shehu**, me funksion, **Zëvendësdrejtor për Rendin dhe Sigurinë në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.**
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë**.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë **21.10.2024**.

TRUPA E VLERËSIMIT

Kryesuese

Suela BULKU

Relator
Arben SEFAJ

Anëtare
Denisa SINA